

## EQREM ÇABEJ

## STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XIII

## L

*labërgój, lapërk'j* "lirij një brez, një nye etj. që ka qenë lidhur shtrënguar". Mungon te G. Meyeri. E jep sëpari Pedersen 151 me formën *lapërk'oj*, për të liruarit e shalës shtrënguar tepër, dhe mendon, me pyetje, si burim të *bark*. Formën *lapërk'oj* e sjell dhe Leotti, ndërsa Godini ka *labërk'oj labërkos*. Është verbi denominativ i *lapërk* f., zgjerim me infiks -kë- i *lapër-s*, kjo vetë një zgjerim me -r i *lapë-s*. *lapërk* nuk asht'e e dëshmuar si e tillë, po vërtetohet indirekt me formën *lapkër* f. "lapër; dackë, flakuri ë" (Fjal. i gju. shqipe), që ka dalë nga metateza e *lapërk-ës*. Verbet me -b-: *labërgoj labërk'oj* rrjedhin prej emrash analoge. Kështu Gazulli jep *labër* "i çlirshëm" përkundrajt *lapër-s* së Elbasanit, që e ka ndër të tjerë dh. Cordignano. - Sh. dhe *labë*.

*lacë* f. Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. Bashkimi e ka për "gherone", Gazulli për "sh jë veçuese, dalluese, sidomos ndër grada ushtarake". Cordignano e jep dhe për "dele me njolla të zeza" e për "një rryp toke", *laca djerrinash*. Edhe emër familjeje në Shkodër. Një zgjerim i *lacë-s* me -an është *lacan* m. "sqap larush, i kuq e i bardhë", te Leotti "sqap i bardhë", te Gazulli 492 si adjektiv *lacan*, fem. *lacane*. Nje tjetër është i *lacëm*, fem. e *lacëme* "me njolla bardh e zi a të kuqleme në njeje të bardhë, thohet për shtazë" po te Gazulli, të dyja për Malsi të Madhe. — Spiegimi etimologjik i fjalës do të niset nga rrethana që *lacë* do të thotë edhe "larë"; kështu Gazulli *lacan* e spiegon "me laca". Si e vuri re edhe Cordignano, *lacë* është *larcë*. Është deminutivi i *larë-s* me -cë-në e geg. veriperëndimore për -zë-në e përgjithshme (sh. për këtë Xhuvani — Çabej, Prapashtesat 27v.) Kështu *lacë* del morfologjikisht identike me *larëz* "Vitis silvestris". Te *lacë* ra r-ja përpara afrikatës, ashtu si te *gacë* (sh. këtë fjalë). Ndërkaq nuk ka rënë r-ja te *larcina* në *Do nierin me larcina* "me lojna" (te A. Sirdani HD XVI 496). Dyshimi i Shp. Bardhit (HD XI 306) për përkatësinë e fjalës *lacë* "rryp toke" te *laca* e mirëfilltë, zhduket vetiut, po të nisemi nga një domethënie e parë "rryp i bardhë, i çelët, i zhveshur" e të krahasojmë për këtë ind. e vj. *lokáh* "shesh i hapët, lëndinë, lit. *laukas* "arë", ags. *léah* "livadh, vend i hapët" që lidhen me gr. *λευκός* "i bardhë" lat. *lux* "dritë", nga fusha e gjuhëve romane frgj. *clairière* "rogë, vend në pyll me bar e pa lisa": *clair* "i qartë, i çelët", sard. (logudor. e vj.) *linthu* "rryp toke" nga lat. *linteum* "copë liri" (Meyer-Lübke REW 072), nga shqipja vetë *çeltinë çeltirë* "n ë copë fushë në mes të pyllit": *çel*, i *çelët*. Që *lacë* "rryp toke" është një me *larë*, e tregon dhe vetë fjala

*l rë në frazën një larë dhe "një copë dhe, një rryp toke". Për kalimin në antik rga "brez" në "rryp toke" khs. shq. rryp toke, rryp dhe "një copë tokë e gjatë e ngushtë" rrypinë "tokë e ngushtë e e gjatë, rryp toke". si dhe gr. e re ζωνάριον si emërtim toke e it. balzo "vend rrëpitë" nga lat. balteus "brez" te Rohlf's EW 755, it. e vj. fascia bruciata "zona torrida" te Alessio, St. etruschi XXIX 379.*

*lagje f. "mëhallë; çetë, grup, tufë njerëzish; palë, anë, kamp; takëm". G. Meyeri 133 e lë të paspicuar. Si tregon Jokli (Revue Intern. d. Et. Balk. I 58 vv.), është plurali i singularizuar i një \*lag dhe si i tillë i afër me gr. λόχος "pusi, pritë; çetë e armatosur; lindje, djergim". Kështu edhe Walde-Hofmann I 778, Pokorny I 658, Hofmann GEW 183v.*

*E ruan vetëm ; egërishtja. Buzuku (LXXVI = LXXXVII, Luka 17,12; LXXXVI/2 = LXXXXVI/2, Apostujt 12,10) E tue him ndë një lagje "Et cum ingrederetur quoddam castellum"; e tue dalë shkuanë një lagje "et exuntes processerunt vicum unum", pra me kuptimin "katund". Budi (RR 15, 163, SC 146, 148, 347) e ka për "palë, grup, parti": e mbasi të kienë hjm ndë kishë njana lagje e klerit të jesënë mbë nja anë tanë, e tjetëra mbë tjetërët. Bogdani (I 73, 9). ndëpër ata të njëmend të zemrës, e të vullëndësë, qi anshtë ndër të dy lagjet së Nierëzet "in quanto çu sia una concordie volonta delli huomini, et un consenso di moltitudine". Si e kemi shënuar dhe në Li Posn. VII 151, singulari \*lag i abstrahuar në këtë mes gjan të jetë poai që ka S. Koleja te fjalori i tij dorëshkrim frengjisht shqip: fr. bande "lag". Përkundrazi Njerstë lagje do t'u ngrënë te Çajupë (Përralla 15), me kuptimin "kurth, grackë", është lag-u, pl. lagje "lak, leqe". Verbet me lague "me instalue" e me lagjue "me lanë pa gjë" te Logoreci 60 janë të pasigurta.*

*lahuri f. "pëllhurë e hollë për linjë grash e për dimitë"; lahur m. "lahuria; shami kreje e grave, e madhe e me xhufka anëve; peshqir me thekë". E ka S.R. Dine (Valët e detit 374) si lahuri; në Dardhë të Pukës Po xhesh xhokën lahuri. Edhe te M. Harapi, Të fejuemit 438. Në Shushicë t'Elbasanit (te një këngë) Bjer lahurin e shaminë, ku lahur është "peshqir me thekë që mbanin pleqtë njëherë". G. Meyeri 236, duke njohur vetëm trajtën lakuri "cipë e hollë e grave", e bashkon këtë gabimisht me lakur lakuriq e lëkurë. Ashtu si kashmir kazmir, edhe lahuri është një emër stofë ardhur prej Hindi, refleksi i emrit të qytetit Lahore, po nga sa duket nëpërmes të turq. lāhuri "shall prej Lahore". Prej andej rrjedh edhe gr. e re λαχουρί λαχουριά, λαχούρι sh. G. Meyer Ngri. Studien II 68, III 82, Andriotis 122.*

*lajka fpl. lajkës, lajkatár m.; lajkatój, lajkatis. G. Meyeri (f. 235, Alb. Studien IV 82) bën një afrim me sllav. vj. kishtarë laskati κολακεύω laska "lajka, dhelka", po shënon veç se -aj- te lajka të bën të dyshosh, qoftë fjala shqipe e afër me atë të sllavishtes, qoftë që të jetë një huazim i saj. Jokli (LKU 204v.), mbi dëshminë e formës lëkëtar μαργιόλος të Kavaliotit, gjen te lajkë një j sekundare, dhe arrin te një formë bazë lak, të cilën e afron me gr. λακερός "llafazan" (te Heziku) λακερούζω "bëj zhurmë" λάσκω "bërtas", lat. loquor "flas" etj. Etimologj e pranuar te J.B. Hofmanni (Walde-Hofmann I 821, GEW 174), sh. dhe Berneker I 692.*

*Nuk duket të ketë një fjalë e mbarë gjuhës, dhe as fjalë e lashtë. Mungon te autorët e vjetër të Veriut e në dialektet e kolonive shqiptare. Mitko 83 e ka për "shaka". Gjindet dhe te N. Frashëri (p.sh. Ist. e Skënd. 13, 211). Një afëri me sllav. laskati, për arsye të formës përjashtohet a priori. Trajta e sotme e fjalës mund të ketë dalë nga \*larkë \*larjkë, me ndrimin e*

*erj-së* në *j* si te *varzë* : *vajzë*, *bir* : pl. *bij*, *duaj* : *dorë*, ndrim që vihet re sidomos përpara *k-së*, sh. *dojkë*, *shajkë*. Kështu *lajkë* mund të jetë një zgjerim me *-kë* i *larë-s*, e cila ka zhvilluar dhe kuptime të figurshme të këtij vështrimi, khs. *laroj* "bëj lara-lara" e "marr me lajka" e "larim "lajkë", e *jetë me lari* "me dredhi e rrena" te A. Sirdani HD XVIII 63. Sh. edhe *lajle*.—Grafia *lajkë* "pirmak, Gitterwerk" te Godini 175 do ndrequr në *Uajkë*.

**lajle** fpl. "zbukurime, ornamente", *me lajle me lule*; figurshëm "dhelka, fedhe". Mungon te G. Meyerit; e ka sëpari Junggu për "fiorame, ornamento", Bashkimi edhe për "moine", bashkë me verbin *lajloj* "zbukuroj". Është një deminutiv më *-lë* i *larë-s*, me kuptimin që ka rrjedhoja e kësaj *larime* fpl. "zbukurime me lajle e me lule", e me ndrimin e shpeshhtë *ri* : *j* (khs. *vajzë*); sh. edhe *lajka*, *laroj*. Në ndjenjën gjuhësore ndërkaq *lajle* u ka përzier me emrin e lules *lale*; prandaj edhe zëvendësohet shpesh prej kësaj, duke thënë *me lale me lule* (sh. *lale*).

**lajth**, *lejthi*, *lethi* f. "Corylus avellana"; *lajthishtë lejthishtë* f. "pyll, me lajthi"; Gazulli *lejthizë* f. "lejthi"; *lajthi e egër* "Corylus colurna, C. arborescens", Mitrushi 337; *lule lejthiçe* pas Gazullit "primula". G. Meyerit 234, duke menduar për *lajthi* një formë më të vjetër *lakthi* e për këtë një bazë \**laks-*, e afron me sllav. e vj. kishtarë *leska* "lajthi", lit. *lazdà* "shkop; lajthi" prus. e vj. *laxde* let. *lagzda* "lajthi". Me gjithë vështirësitë fonetike që paraqet ky barazim si për shqipen si për sllavishten e baltishten, është pranuar prej shumësh : Lidén (IF 18., 487 v., ky duke shtuar dhe arm. *last* "argisht , lundër; dërrasë; shtrat"), Berneker I 736, Walde-Pokorny II 387, 442, Ostir Arhiv za arb. starinu II 54, Bariç (I 44 v., Hymje 44), Vasmer REW II 53 v. (me literaturë). Jokli (LKU 203 vv., 323 vv., Archivum Romanicum XXIV 30 v.) e pranon, duke parë te *lajthi* një *j* epentetike e duke çuar *lëth-i* te një bazë shqiptare \**ladh-* e këtë te një indoaur. \**lag'*. Ai shprehët kundra bazave \**leshk-th* e \**lex* të Bariçit; e kundra Tagliavinit (f. 166 v.), i cili mbi dëshminë e formës *lakthi* të Borgo Erizzos anon nga rindërtimi i G. Meyerit. Me bazën e Joklit bashkohet Pokorny I 666 e Fraenkei 348.

Fjalë e mbarë gjuhës, del që te Buzuku (LIV/2, Danieli 13,54): *E aj i tha: Përndenë një lajthi* "Qui ait: sub schino", me përkthim të pasaktë. Afrimi me fjalët balto-sllave çalon pikësëpari nga puna se sllav. *leska* nuk e bashkojnë më me lit. *lazda* etj., po këtë grup e lidhin vetëm me sllav. *loza*, sllav. e vj. kishtarë *loza* «*ἄμπελος κλήμα*». Më të mëdha janë vështirësitë fonetike në barazimin sllav. *loza*: lit. *lazda* let. *lagzda* prus. e vj. *laxde*: shq. *lajthi*, të cilat për ne janë të pakapërcyeshme. Për bazën e fjalës shqipe do të kthehemi ndërkaq te mendimi i G. Meyerit, aq më shumë kur *lakthi* dëshmohej tani për një dialekt të shkëputur prej kohe, siç është ai i Borgo Erizzos. Forma *lakthi* është një zgjerim me *-i* i fjalës *lakth*. m. "syth i rjetës; litar për të mbajtur barrën e druve në samar; lasso; dell i Akilit; cartilago thyreoidea", poashtu siç është *ardhi hardhi* një zgjerim i *urth urdh-it*. Lajthia pra e ka emrin nga *lak* "gjalmë, litar; dredhë prej lëkure për opinga; hark i lahutës, të lakuarit," pl. *leqet* (e *këmbës*); ep *lak druja* "përkulet," *lako* "kthej në trajtë të harkut". Dihet se druri i lajthisë është i lakueshëm dhe se arqitat e përkulshme të saj shërbejnë për të thurur shporta e për rrrathë kadesh, sh. dhe Mitrushin 339. Gaturali *k* para spirantit *th* o *z* kthehet diku-diku në spirantin *j*, nëpërmes të shkallës *q*; khs. *bark*: *baqth bajth* "fondi i barkut,, (G. Meyer 27), *pakëz* në Di-bër *pajzë*. Kështu *lajthi*, duke i përkultur *lak-ut*, nuk ka lidhje ne fjalët baltoike e sllave kue kanë venduar. — Sh. dhe *lajthatë*.

**lamardhe** fpl. E ka D.P. Suli (Leka V 53) në frazën *nizshin zermure e flakadaj e lamardhe*, pra, nga sa duket, "pishtarë". Te Xhuvani-Çabej (Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 79) spiegehohet gabim si *la-mardhe*, prej *mardh*. Gjan të jetë një me *llambadhë* "qiri i trashë prej dylli, shandan, harzane", po *lamardhe* prej gr. së mesme **λαμπάδα**, me epentezë të një *r-je*.

**lamnishim** "i hollë e i gjatë nga shtati". Fjalë e shqipes së Greqisë. Për këtë G. Meyeri (Alb. Studien V 92) jep një mendim të Reinholdit, i cili e lidh me *lamë lëmë* «**ἀπό τοῦ σωροῦ τῆς ἄλω**». Nuk është gjë tjetër veçse një mbiemër rrjedhur nga *llamni* "tyta e dyfekut, e pisqollës", që është e hollë e e gjatë. Për të tilla metafora khs. *lastar*, *purtekë*, gjerm. *gerten-schlank*.

**lanok** m. "kusar, hajdut". Fjalë e geg. veriore, regjistruar sëpari te Bashkimi. Cordignano jep për Zadrinë dhe *landok*. Është një zgjerim me *-ok* i *landë-s*, pra "druvar, sëpatar", me një zhvillim pejorativ të kuptimit, i shpeshtë në emrat e zejtarëve, shih. Studii si Cerc. *lingvistice* X 4 (1959) 556.

**lapë** f. "pjesa rrypake e mishit, zhangël; lëkura që i varet kaut nga gusha gjer në gjoks". G. Meyeri 237 e jep për "rreckë, zhele", e për "rrudhë, (te de Rada), bashkë me *lapandár* "rreckaman", dhe e krahason me gjerm. e lartë të vj. *lappa* "rreckë", lit. *l pas* "rreckë", serbokr. *lapat* "rreckë, arnë, etj. Etimologji e pranuar te Berneker I 691, Walde-Pokorny II 429 v., Vasmer REW II 14 (ue literaturë), me rezervë edhe te Walde-Hofmann I 762. Më anë tjetër Jokli (Studien 46, LKU 88 v., Revue Intern. d. Et. Balk. II 77) *lapë* "lëkura e barkut të bagëtisë së therur e ato që i përngjajnë asaj" të Kristoforidhit e afron me gr. **λέπω** "qëroj" **λέπος** "guall, lëvore, lëkurë", sloven. *lepen* "fletë, gjeth" etj., e brenda shqipes me *lepj* "gdhend, latoj, daltoj". Spiegim që pranohet te Berneker I 701, II 4330, Walde-Pokorny II 418, Walde-Hofmann I 785, Pokorny I 678, Vasmer REW II 31 v., Hofmann GEW 177.

Është një fjalë e vetme, me degëzime të kuptimit po që bashkohen të gjitha te ai i një lëkure rrypake. Për ndryshimet kuptimore khs. p.sh. serbokr. *lapat* "copë, rreckë, arnë", pl. *lápaci lapataka* "bark, mullë, zorrët e ripertypësve". Të dyja krahasimet jashtë shqipes janë me udhë, po dhe grupet e fjalëvet indoeuropiane që afrohen të dy herët për krahasim nuk është pamundur që të përfshihen në një rrënjë të vetme. Një zgjerim i kësaj së fundit me një *-kë-* si infiks është *lapkër* "lapër; dackë, flakurimë", prej së cilës rrjedh dhe *labërgoj labërkoj* (sh. atë fjalë). Një tjetër formë e *lapë-s* është *labë* (sh. këtë). Një zgjerim me *-é* është *lapé* f. "vathi i dhisë", një me *-ér lapér* m. "rrugaç, rreckaman", fem. *lapere*. Nga një përzjerje e *lapë-s* me *petë* ka dalë *lapetë* "lëkurë e barkut të shtazëve të therura; llapë petkash për zbukurim". — Sh. edhe *lafshë*, *lapërdhi*, *lëpéc*, *lëpushë*, *lopë*, *llepë*, *llapushë*.

**laps** I. "lodh, këpus", më fort në aorist, intrans. *lapsa nga ky njeri* "u lodhshë me këtë njeri", *lapsa me ty* "u lodhshë me ty", *mos më laps* "mos më lodh". E paspieguar te G. Meyeri 237 e te Weigandit 45. Pas Joklit (Studien 48) e afër me gr. **λαπαρός** "i flashkët, i qullët; hollak" **λαπάσσω** "zbraz, zorrët e barkut" **ἀλαπαδνός** "i dobët, i ligshhtë", lit. *alpsü* "me u dobësue". Vihet në dyshim te Walde-Pokorny I 92 ete Pokorny I 33 jo vetëm fjala e shqipes, po gjithë barazimi si i tillë.

Fjalë lokale (pas Kristoforidhit e Elbasanit), e cila vetë me pjesën fundore *-ps* dëshmon për burimin e saj ga greqishtja, poashtu si *paps*, *moleps*, etj. Nga gr. **βλάβω**, **βλάπτω** **βλάφτω** aoristi **ἔβλαψα** "dëmtoj, prish, bëj keq"; khs. fjali të tilla si **βλάπτει ἀπ'τῆ σπουδῆ**

"u lodh, lapsi nga studimi" e të tjera shembëlla të Dimitrakos III 548 v. Një tjetër refleks i fjalës greke është *laps* II. Një i tretë është *lavem* e Arbëreshve t'Italisë (sh. atë fjalë). Në të gjitha këto fjalë ra *v*-ja në grupin *vt* nistor, *v* i te *lastar*, *li-a* etj. Te *laps* e te *lavem* kemi të bëjmë me dy huazime mesjetare të fjalës greke në gjuhën shqipe.

**laps** II. "dëshiroj". Mungon te G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për të folët e Tiranës, me kuptimin "**ἐπιθυμῶ**". Pas Joklit (Studien 48, LKU 76) është reflesi shqiptar i rrënjës indoeur. \**leubh-*, në lat. *libido libet*, got. *galaufts* "për t'u dëshiruar, i vlefshëm", sllav. *ljubiti* "me dashhtë" etj. Etimologji e pranuar te Berneker I 757, Walde-Pokorny II 419, Walde-Hofmann I 793, Pokorny I 683, Vasmer REW II 77.

Fjalë dialektore, përdorimet e së cilës tregojnë se e ka burimin gjetiu. Në Tiranë thonë *lapsa ta gjija* "plasa, u përpoqa, bëra çmos ta gjëja", *lapsi ta merrte* "plasi ta merrte" (për grua). Përdorimi me aorist dhe kuptimi tregon se është një me *laps* I "lodh, këpus", *lapsa me ty* "u lodhshë me ty". Fjala e shqipes që hyn në grupin sllav *ljubiti* është *typ*.

**lar**çj "marr me lajka", *larim* m. "lajkë". G. Meyeri 238 e lë pa spjegim. Bariçi (Arhiv za arb. sterinu I 153) e krahason me sllav. *laskati* "me lajkatisë". Me të drejtë Jokli (IJ X VII 67) e barazon me *laroj* "bëj lara-lara, laros", dhe për anën kuptimore krahason gr. **ποικίλλω** "laros" e "lajkatoj", Sh. edhe *lajka*, *lajle*, *lurtoj*.

**lashtë** (i) "i moçëm, i shtymë në mot (për njerëz e për shtazë); që ka ngjarë qëmoti (për sende)"; *qingj i lashtë* "qingj pjellë para kohe", *shqerra të lashta*; *fiq të lashtë* "fiq të parë, fiq shëngjini"; *kollomboq i lashtë* "që piqet heret", *njeri i lashtë* fig. "gojëlashtë"; *të lashta* fpl. "drithërat, kur janë edhe në arë"; *lashtoj* "plakem, bëhem i lashtë"; *lashton misri* "piqet para kohe"; *lashton bagëtia* "pjell para kohe"; *lashtohem* "bëhem i lashtë, vjetërohem", *u lashtua plaga*; *lashtë lasht lashti* "qëmoti, moti"; *ka lashtë kjo punë*; *bimë e mbjellme lashtë* "mbjellë me kohë, heret", Bregu i Detit *lashtërisht* "lashtë, qëmoti (M. Totoni); *lasht* m. "kohë": *asi lashti*. Spjegimin që jepete G. Meyeri 238 prej lat. *lassus* "i lodhët" e lëfton me të drejtë Jokli (LKU 226 vv., Slavia XIII 309). Ky djetar, duke u nisur nga forma *lash* e Kalabrisë e duke e çuar atë te një bazë \**loud-sio* \**laud-sio*, gjen aty një fjalë me kuptim të parë "i pjekur, i rritur". Kështu *lashtë*-n e afron përbrenda shqipes me *lej lind*, me *këlysh* e më i *lartë*, e më tej me got. *liudan* "me u rritë", gjerm. *Leute* "gjind", ind. e vj. *rodhati* "hypën, rritet". Etimologji e pranuar te Walde-Hofmann I 793.

Është një me *lashtë* f. "vesë; një vesë shi, shi i hollë, vrug që prish të lashtat". Meqë për këtë ekziston edhe *lakshhtë* "vesë, pika shiu" e *lakshitim* m. "lagështinë" (te Weigandi) e *lakshte* f. "lakshtë" *lakshitinë* f. "lagështinë", shihet se *lashtë* "vesë" e *lashtë* janë në analizë të fundit zgjerime të verbit *lag* - me *-shtë*. Për rënien e guturalit si konsonant i tretë në bashkim me *-sht-* khs. i *ploshtë* pranë i *plogshhtë*, në Lumë *lisht* për *liksh*. Për zhvillimin e kuptimit do pasur parasysh se i *lashtë* me *të lashta-t* është një fjalë e dukurivët atmosferike, përdorur dhe në fushë të bagëtisë e të bujqësisë në rrethanat e një ekonomie e të një kulture zhvilluar pranë natyrës. Kuptimi bazë i fjalës është "i lagshtë, i njomë". Kështu *fiq të lashtë* janë "fiq të njomë", e *qingj i lashtë* është "qingj i njomë, kërthi"; khs. për këtë gr. **ἔρσαι** "shtjerra kërthia": **ἔρση** "vesë", **δρόσοι** "shtazë kërthia": **δρόσος** "vesë", **ψάκαλον** "shtazë kërthi": **ψακάς** "shi i hollë, një vesë shi" te Boisacq 284. Prej këndej u zhvillua më tej përdorimi "pjellë para kohe; pjekur para kohe". Kështu *të lashtat* janë drithëra që piqen që në verë, në kundërshtim me *të vonat*, që janë drithërat

(e pemët) e vjeshtës. Kështu spjegohet dhe mbë *lashtë* "ένωρίς, heret" te Kullurioti 142. Nga "pjellë heret, pjekur heret" u zhvillua kuptimi "i pjekur" përgjithësisht (Ali Ulqinaku i *lashtë* = turq. *ergin* = i pjekur). Që këtej doli sëfundi dhe kuptimi "i moçëm", duke arritur fjala kështu në një domethënie të përkundërt me të parën që ka pasur, e që është "i lagshhtë, i njomë". Te "i moçëm" lidhen dhe *lasht* "kohë" e *lashtëni* f. f. "antichità,, te Bogdani. Në këtë mënyrë i *lashtë* sqarohet me mjetet e brendshme të gjuhës, si një nga ato fjalë që janë përkthyer nëpër një skala të tërë kuptimesh, shpeshherë të përkundërta. Për sufiksën *-shtë* në emra e mbiemra e *-sht* në ndajfolje sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 87 v.

latin m.; *latinisht*; *latinishte* f.; *lëti* m. "latin, europian; katolik", fem. *lëtineshë*; *lëtisht* "italisht". Pas Miklosichit (Alb. Forschungen II 440), G. Meyerit 238 v. (sh. dhe Ngri. Studien III 38) nga lat. *latinus*; sh. dhe Tagliavini 169v.

Latine janë vetëm format geg. *lëti*, në shqipen e Italisë *lëtir*, në Mollize (Lambertz KZ 53, 292) *Lëtint Lti* "Italianët; katolikët", këtu e atje *lëtisht*", "italisht", poashtu dhe në Borgo Erizzo. Gjithshka te këto forma flet për një huazim të vjetër, të kohës romake: *a: ë, in: i, -n: -r-*. Përkundraz i *latin* (armë latine te P. Vasa) është huazim prej italishtes. Edhe më të reja janë *latinisht*, *latinishte*.

*lavare* f. "litar për të varur një njeri; kapistër". Mungon te G. Meyerit; e kanë të tjerët fjalorë, sëfundi edhe Tase; e përdor me kuptimin e parë dhe Gjirokastra (*tij je për lavare*); N. Frashëri (Ist. e Sk. 32) *hell edhe grep e lavare*. Është formë femërore e *lavar-it* m., te Cordignano "kular", te Gazulli "rreth thuprash për me kapë shtin e parmendës me zgjedhë, hallkë qeni; loze, paska lëshue kungullë *lavarët*". Kuptimi i përbashkët i të dy fjalëve është "lidhës, litar". Forma është *la-var*, një postverbal i *var* me prefiks *la-* prej *lë* në pozicion para theksit; kështu dhe Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 76. Aty hyn, si një zgjerim me *-ak*, dhe *lavrak* m. "lakim", si adverb "në formë valash" që dëshmon po Gazulli për Dukagjin e për Malsi të Madhe. Një kompozit i *lavar-it* me *gë-* e me shpërngulje të theksit është *galavër* (sh. këtë fjalë). Me tjetër vokalizëm të prefiksit hyn këtu *livare* f. "katarakt, ujarë" me *livarës* m. "gjë që varet nga sipër e tundet" e *livarëz* f. "vastak"; sh. dhe *kalivare*, *vastak*. Prej *vjer virem* janë formuar me *lë-* *la-* i *lëvirem* "i përlëkurem, i lutem me aman" bashkë me *lëvirë* f. "lutje me aman", pastaj *lavire* f., *lavjere* m., *lifqer* m. (sh. këto fjalë). — Khs. dhe *lëvroj*.

*lavinj* "marroj, çmend", *lavem* "çmendem; keputem, zbehem", i *lavur* "i marrë". Fjalë e shqipes së Italisë, të cilën G. Meyerit 239 e bashkon me *laosem* "trullosem" që ka Mitko, po më tej s'e spjegon. Bariçi (I 108) sheh një fjalë të trashëguar, të afër me ind. e vj. *lajjate* "i vjen turp" gr. *λώβη* "mbarre, dhunë", po më fort me lat. *languo* "jam i këputur, lëngo".

Fjalë dialektore, me *l* gjysmëvelare, jo palatale (*l'*) si e jep G. Meyerit. Nga spjegimet indoeuropiane të Bariçit asnjëri nuk qëndron, as nga pikëpamja e tingujve, as nga e kuptimeve. Nuk ka dyshim që *laosem* e Mitkos është *lavósem* "plagosem" nga *lavos* (sh. këtë fjalë). *lavem* e i *lavur* të arbërishtes së Italisë Kamarda (I 99, 124, 347) anon ta spjegojë më fort nga gr. *βλάπτω βλάβω*, "dëmtoj" sesa nga *lavos λαβώνω* "plagos". Me gjithë se ai tërë krahasimin e ka pështjelluar sipas zakonit, duke lidhur *lavos* me *lodhem*, spjegimi i *lavem* nga gr. *βλάβω, βλάβομαι* "dëmtohem, prishem" është i sigurtë. Vetë në greqishten, *βλάπτω* ka qëmoti dhe kuptimin e figurshëm « *πρό τόν νόον, τάς φρένας, διαταράσσω, μωραίνω, ζαλί ζω* » te Dimitrakos II 1423, sot edhe « *ταράσσω τήν ύγιεινήν κατάστασιν τινος είτε σω-*

ματικῶς εἶτε διανοητικῶς, ἐπὶ μαγισσῶν, κακοποιῶν δαιμόνων, νεκροῦ ψυχοραγοῦντος etj., ὁ βλαμμένος τὸν νοῦν, παράφρων." Ἱστορ. Λέξ. τῆς νέας ἑλληνικῆς III 549. Kështu shqipja e ka marrë fjalën me këtë kuptim prej greqishtes. Spiranti nistor ra ashtu si te *lastar*, te *li-a* etj. Baza nuk mund të jetë aoristi ἔβλαψα, i cili ka hyrë në shqipen si *laps* I. e II. (sh.këto fjalë), po βλάβω βλάβομαι e greq. mesjetare. Spiegimi nga kjo fjalë greke është më i sigurtë sesa ai nga λαβώνω "plagos"; kjo jo për arsye të kuptimit, se dhe λαβώνω ka në greqishten kuptimin e të dalit menç, po për arsye formale: λαβώνω ka dhënë rregullisht *lavós*; *lavem* është tjetër fjalë.

*lavire* f. "grua e ligë." Mungon te G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për Tiranë. Kuptimi i parë është "rreckë", sikundër tregon dhe pl. *lavire-t* "rrecka të ndyra". Për semantikën khs. lat. *scortum* "lëkurë" e "lavire" (me plot paralele te Walde-Hofmann II 497), gjerm. *Kebse* "konkubinë": dial. *Kabe* "lëkurë peme", gjerm. e ulët e mesme *slüve* "meretrix": gjerm. e sotme *Schlaube* "guaskë, lëvore e pemës" etj., sh. H. Schröder, Zeitschr. f. deu. Phil. 38, 518 vv. Etimologjikisht *lavire* "rreckë: grua e ligë" shkon me *lavirë* "rrëke mali, përroskë; vend rrëshqitë; gjurmë e rrëshqitshme e bagëtisë; grua e ligë" (sh. dhe Illyria I 25, 8), *lavirem* "rri varë, rri pezull", *lavjërre* (sh. këtë fjalë). Të gjitha janë kompozite të verbit *vjerr virem* me *la-*, zhvillim i prefiksit *lë-* në silabë paratheksore. Të tjera fjalë të afra janë grupuar te *galavër*, *kalivare*, *lavare*, *lëveve*, *lëvozhgë*, *lifqër*, *vasták*, *Kalivaç*, *Ljarje*.

le, pjesëz që shërben për formim të imperativit (formalisht identik me koniunktivin), sidomos në veten e tretë, *le të vejë*, *le të shkojnë*. Është trajta e gjymtuar e imperativit të verbit *lë lë* në veten e dytë të njëjësit; khs. Hahn Gram. 65, Kamarda I 255, G. Meyer Gram. 41, Pedersen 151, Pekmezi 76 v., Lambertz 105. Edhe në të tjera gjuhë forma imperative e verbeve që duan të thonë "lë", "jap" etj. është reduktuar në një pjesëz me funksion të tillë, si let. *lái* prej *laid*, angl. *let* (*let us do* "le të bëjmë"), gjerm. *lasst uns hören* "le të dëgjojmë", sllav. *da*, gr. e re ἄς nga ἄφεσ etj. Khs. Fraenkel IF 41, 397; 43, 304v.

leblebí. f. "qiqëra të pjekura". G. Meyeri 302 jep (pas Mitkos) vetëm formën *neblebí*, dhe këtë e lë të paspieguar. Nga turq. *leblebi*, e cila ka shkuar dhe në të tjerat gjuhë të Ballkanit, sh. Mladenov 271, Andriotis 123. Forma *neblebi* i detyrohet disimilimit *l-l: n-l*.

I ck f. "rreckë, zhelë"; *leckós* "rreckos, zheloj"; *leckamán* m. "zhelan". Afrimi me sinonimin *rreckë* nga ana e G. Meyerit (f. 373) nuk përlligjet fonetikisht, një ndrim *r:l* nuk ndeshet në gjuhën shqipe. Shumë-shumë mund të pranohet një ndikim reciprok i të dy fjalëve në punë të formës, meqë përbëjnë një çift që formon rimë. *leckë* gjan të jetë një zgjerim me *-kë* i fjalës *lesë* "leckë e lyer me të cilën pastrojnë", kjo një postverbal i *lyej leva* me *-së*. Në këtë rasë te *leckë s-ja* në afërsi të *k-së* u ka fortuar në *c*; khs. *ckërkë*, *ckërfyell*.

I n̄ (i); *lehtësój lehcój*. Fjalë me gurrë të diskutuar. Shumica e dijetarëve (ndër ta Boppi f. 462, 490, 542 shën. 61; G. Meyeri f. 239v., Alb. Studien III 10v., IV 48; Pedersen Kelt. Gram. I 69; Bariçi I 217; Tagliavini 170) gjejnë këtu një fjalë vendi, e afër me lat. *levis*, gr. ἑλαχύς, ind. e vj. *raghú-* etj. Kështu dhe shumica e fjalorëve etimologjikë, si Boissacq 239, Berneker I 753, Walde-Pokorny II 426, Hofmann GEW 77. Përkundrazi Puscariu EW 1844, Meyer-Lübke REW 5004, Jokli (te Walde-Hofmann I 789) e spiegojmë nga lat. *levis*. Pokështu Pokorny I 660 v., si dhe Vasmeri (Studien I 38), i cili edhe në REW I 24 v. s'e shënon fjalën shqipe. Sh. dhe Tagliavinin 170.

Fjalë e gjuhës mbarë, format e së cilës peshojnë në punë t'etimologjisë. G. Meyeri arriti te *leh* si forma bazë, zgjeruar me *-të*. Si e kemi shtjelluar dhe në Bul. për Shk. Shoq. 4 (1955) 119v., baza e fjalës është *lë*, *i lë*, sikundër del nga dëshmia e përbashkët e literaturës së vjetër dhe e dialekteve: Buzuku (LXXXVI/2=CVI/2, Mateu 11,30) *Përse zgjedha eme anshtë e amblë, e të randëtë tem anshtë të lë* "Iugum enim meum suave est, et onus meum leve est"; Budi (DC 108, SC 11) *i lë*, fem. pl. *të lea*, Bardhi Fungosa res *E lë kafshë*, Levis *I lë*, Leve pondus *E lë barrë*, Levitas *Të letë*; Bogdani (I 38, 28) *ndëpër të lëtë vet* "con la sua leggiereza", Kavalioti *i lë*, Hahni (II 135) *O e mir'e fjalë-lë*, de Rada *N'atto zëmëra të l'ea*, Dorsa (Mateu 11,30) *barra ime është e lë*. Në Greqi (G. Meyer, Alb. Studien V 17) *më leh*, Grigori (f. 37) *i lehë*, poashtu Gjirokastra. Prej *lehë* edhe verbë *lehoem* te Fjal. i gju. shqipe. Me zgjerimin me anë të sufiksit *-të* i *lehtë* ndoqi tendencën për të pajisur mbiemrat me formante të reja si *-të*, *-ën*, *-ër*, për të cilën sh. vrejtitet tona në vendin e cituar. Te i *lehtë* sufiksi *-të* mund të ketë hyrë nga neutri *të le-të*, që del p.sh. te Budi (SC 10), si *të le t e pëndesësë*, Bardhi Levitas *Të lëtë*, poashtu dhe Bogdani. Te *lehë* nga *lë -h-* ja ka hyrë për të ndaluar hiatin. Pra zhvillimi ka qenë *lë*: *lehë*: *lehtë*. Për etimologjinë ka rëndësi gjatësia e vokalit të fjalës. Kjo e e gjatë dëshmon për një lloj zgjatim kompensimi (Ersatzdehnung): zgjatim që rrodhi nga të rënët e një okluzivi të zëshëm midis vokaleve të dy silabeve të dikurshme e nga kontraksioni i atyre. Pra baza parashqiptare ka qenë një \**leg<sup>h</sup>ho-*, afërsisht ashtu si e cakton Bariçi e La Piana (Studi ling. alb. I 94). Nga gjatësia e vokalit te *lë* shihet se është vështirë të mendohet një burim i fjalës nga lat. *levis*. Si opoziti i saj *rëndë*, edhe *lë leh(-ë) lehtë* është fjalë e fondit autokton të gjuhës. — Sh. dhe *lenoj*.

lej. G. Meyeri 241 mendoi për një burim nga lat. *lecare* "me ngritë", po vuri re vërtet që s'mund të ndahet fjala nga *lind lindem*. Pas Joklit (Studien 49, LKU 42 vv., 262) është fjalë vendi, prej një baze \**leudh-n-*, e afër brenda gjuhës me *vëlla*, me *këlysh* e me *i lashtë*, më tej me got. *liudan* "me u rritë" *liut* "popull" gjerm. *Leute* "gjind", sll. e vj. kishtarë *ljudъ* "popull", let. *lāudis* "gjind" etj., duke venduar këtu dhe emrin *polém*. Etimologji e pranuar me rezervë të Walde-Pokorny II 416., Pokorny I 685, e pa rezervë te Weigand 46, Walde-Hofmann I 791; sh. edhe Berneker I 758, Tagliavini 170. Sëfundi La Piana (Studi ling. alb. Varia 29 v.) e afron me Εὐλείθυια, emri i hyjneshës që mbronte lindjet te Grekët e vjetër, e me lat. *liberi* "fëmijët, culltë", po për fjalën latine nisët nga tjetër bazë.

Për të sqaruar punën e burimit të fjalës duan shikuar format e saj e përdorimet e tyre. Në shqipen e vjetër *lej* është verb transitiv me kuptimin "pjell; gjeneroj", *lehem* intransitiv "nascor", poashtu *lindem*. Kjo skemë e parë u ndërlíkua pastaj në format e saj, duke u zhvilluar ato të gjuhës së sotme, po del e qartë me një krabasim të dëshmimeve të vjetra me rrethanat e dialekteve më arkaike. Kështu Buzuku ka (LXXXV/2=LXXXXV/2, Luka 1,13; LXXXIX/2=LXXXXIX 2. Mateu 1,2; LV, Galatët 4,23; LXXXV=LXXXXV, Gjoni 3,4; XLII 2. Isaia 58,10) e *gruoja jote Elisabeta të lenjë një djalë* "et uxor tua Elisabeth pariet tibi filium"; *E Abraami leu Izakenë, e Izaku leu Jakobnë* "Abraham genuit Isaac, Isaac autem genuit Jacob", *E aj qi u lë n sherbëtoretet, leu si për zakon r mishi, e aj qi leu n ngruojet, për të prometuemet* "Sed qui de ancilla, secundum carnem natus est: qui autem de libera, per repromissionem"; *Si mundë lihetë nier, të dytënë herë, tue kleñë plak? a mundë hinjë ndë bark të s amësë kaha duol e me u lem për së dytë?* "Quomodo potest homo nasci, cum senex

sit? numquid potest in ventrem matris suae iterato introire, et nasci?"; ndë t erëtit të lindetë drita jonë "orietur in tengbri lux"; intransitiv (LVII, Gjoni 9, 20) Na dimë se kÿ anshtë ynë bÿr, e se aj verbënë leÿ "Scimus quia hic est filius noster, et quia caecus natus est"; participi qi anshtë lëm. Tue klenë lëtë "Cum natus esset", anshtë lenë, e cila i përgjigjet tosk. lerë; infinitivi ke me lëm Bÿrë "et paries Filium". Budi (SC 53, RR 194, DC 214, SC 117) atq qi të kanë lëm, e rritunë e ruojtunë; gruolja mbassi kã lëm foshnjenë; Mbë këtë jetë me lëm:qi posa lën foshnja ndë shtëpi të tyne. Bardhi Conceptio Të lindunë, Conceptus Lindunë, Nascere Me lëm, Nativitas Të lëmitë, Natus Lëm, Oriri Me lëm, Renasci Me lëm përsëriu, f. 197 Vendi ku kã lëm e dalë ajo Kulshedra e botësë Arbënit, 212 Possi leu ashtu des nierÿ. Bogdani (I 69, 1; 8,7; 50, 13) Nje vajza ka me zanë, e me lëm bÿrrë "Ecce Virgo concipiet, et pariet filium; përse tjetër anshtë aj kahë len, e aj qi len "attesato che altro è la persona generante, e altro la persona generata"; I lenë Adamit sa kje gjall Kaini, e Abeli, vëllazënë "Nacquero ad Adamo, mentre visse, Caino e Abele, fratelli"; lës "generante". Matranga 51 Të lërëtë të Krishtit Zotit tinë. Në shqipen e Greqisë lehem; i bardhë u leshë, i zi u ndodhshë (Poros, sh. Reinhold, Glosari 16, Antologjia e litografuar 43), Kupitori (ἱατριβή περί τῆς παρ' Ἀλβανοῖς ἀνωθυμίας τοῦ τρίτου προσώπου 16) u lë "ἐτέχθη", Kullurioti (Abetari 113v., 118) sot lehem i nestrë vdesmë; s'jeshë lerë fare; si bënëhet të lëhetë njeri, të jetë edhe plak? (G. Meyer, Alb. Studien V 49). Te de Rada (Fiamuri Arbërit I 1) të l'ëra ndë Morët "nati nella Morea"; në Sigeli lëxëmë "sono partorito, cioè nasco" (Kamarda I 44), te Z. Skirò (Canti tradizionali 70) si edhe hera kÿr u leve "anche l'ora in cui tu nascesti". Grigori (f. 4, Mateu 2,4) e i pieti ata të mpon ku vallë lëhetë Krishti; Pedersen (f. 151) lehem, u lenë. Emri postverbal lindje është i ri, del sëpari te Weigandi me kuptimin gjeografik. Forma popullore është trajtuar prej lej, në Gjirokastër me -lë lejlë, në frazën as për lejlë as për vd. këllë, te Fishta (Anzat e Parnasit 3, 115) n'anë prej lejet "prej Orientit".

Për historinë e fjalës do venë re se shqipja, ashtu si baltosllavishtja (sh. për këto gjuhë Ernout-Meillet 418), nuk merr pjesë në rrënjën indoeur. \*g'en- \*g'ene- "pjell, lej" veçse me emrin dhëndër; e pjell pjellë f. na shpie te një tjetër rrënjë. Për etimologjinë do kthjelluar raportit formal midis lej e lind. Pedersen (f. 12) me shënimin "fjalës lind "pjell" i përkisnin në krye të herës format pa n e me d zhdukur rregullisht pas ligjeve fonetike, prej nga doli lenj" lë të kuptohet se ai -d- në lind e merr për një tingull me ekzistencë të qëmoçme, jo për një shtesë sekundare. Edhe Jokli me afrimin që bën me got. liudan, me përpjestimin e tij lindem: lenj si (z)gjindem: gjenj e me shënimin (Studien 63) që te lind ka një formim me -n-, shpreh mendimin për karakterin origjinal të -d-së e sekundar të -n-së te lind. Për një gjykim të burimit të fjalës na duken qenësore dy vetija të saj të pavënare gjer tani: në pikëpamje të formës vokali i gjetë, në pikëpamje të kuptimit përdorimi transitiv "pjell"; e para tregon se ka pasur rënie të një tingulli a silabe, e dyta se do kërkuar etimologjia gjetiu. Shq. lenj lej nga një \*legnio afrohet brenda gjuhës me lagje (sh. këtë fjalë) e në rendin indoeuropean me lat. lectus "shtrat", irl. e vj. lige "shtrat, varr", got. ligan "me ndejtë ratë", lagjan gjerm. legen "me vendue, me vu", sllav. e vj. kishtare ležati "κείσθαι", lit. palegis "të qenët ratë në shtrat", gr. λέχος "shtrat", λέγεται κοιμάται, λεχό "lehonë" etj. Nga kjo rrënjë indoeur. \*legh- "vë, vendoj; shtrihem, bie poshtë", e cila i mungon indoiranishtes e armenishtes (Ernout-Meillet 534), gjuha shqipe ka ruajtur verbin e shkallës e, lej, dhe emrin lagje, kjo në apofoni të rregullt

(e:o) me atë. Në shqipen, me përdorimin e shpeshtë me objekt, me *lēm* djalëtë "τέκνον τέκτειν", fjala humbi me kohë kuptimin e përgjithshëm "ve, vendoj; shtroj" dhe e ngushtoi në "pjell", kuptim që i mbeti dhe kur u përdor pa objekt. Për një të tillë zhvillim semantik khs. frgj. kat. *pondre* "me pjellë ve, me vojte" nga lat. *ponere*, frgj. *accoucher* "me lindë" nga *coucher* prej *collocare*, *mettre bas*, rum. *a depune* "me pjellë" (për bagëti) nga *deponere* etj., sh. Meyer-Lübke REW 6647, 2052; Bogrea Dacoromania III 444. Ndërkaq është për të vënë re se te Buzuku fjala ka ruajtur dhe domethënien e hershme: *tue lenë për së nalti* "duke zbritur së nalti"; *E dërgoi pëllumnë mbas korbt, me pām pam a ishnë nēm ujënatë përmbi dhët* "Emissit quoque columbam post eum, ut videret si iam cessassent aquae super faciem terrae"; *E njohi Noe se ujënatë ishnë lēm përmbi dhët* "Intellexit ergo Noë quod cessassent aquae super terram"; *e asnjë η sish nukë lindëte mbë dhët pa Atënë taj* "et unus ex illis non cadet super terram sine Patre vostro", khs. Grigorin *e ndonjë nga ata nukë do të bjerë më dhe....* (IXa; LX/2=LXX/2, Gjenezja 8,8; LXI=LXXI, poaty 8,11; LXXXIV=CIV, Mateu 10,29). M'anë tjetër do shënuar se kjo rrënjë edhe në të tjera gjuhë indoeuropiane ka zhvilluar kuptimin e të lerit; gr. λόχος edhe "të lindurit, pjellë", λοχεία "të lindurit" λοχεύειν "me le", sllav. ložezna "mitër" (khs. *lemzë* II, *klemëz*). — Formalisht *lenj* nga një bazë \*legniō, \*leniō; lind nga \*legnō \*lenno, me nd im *ei* para konsonantit dyfish e me *-d* fundore sekundare. Për zhvillimin e kësaj me rrugë thjesht fonetike sh. Bul. për Shk. Shoq. IV (1953) 36, 38. Shkalla fonetike me *i*, sot vetëm te *lind*, te Buzuku del dhe te *lej*, te *lithet* "lehet" që u pa më sipër.

*leje*, *lejë* f.; *lejój* "jap lejë", *lejīm* m.; *fjali lejore* "fjali koncensive". Mungon te G. Meyeri; e ka sëpari Bashkimi. Fjalë e re, lindur brenda fjalisë urdhërore, si një leksikalizim i *leje* "lere atë", sigurisht neologjizëm i ndonjë anonimi. Këtë spjegim duket të ketë pasur në mend edhe Weigandi 46, kur shton gjerm. *zulassen* "me leje" (*lassen* "me lanë"). Për kuptimin khs. angl. *leave* "leje"; *to leave* "me lanë". Autorët e vjetër të Veriut përdorin më fort *me permetuom* "me leje" nga it. *permettere*. Bogdani ka *testir* "licenza", prej turqishtes. Me kohë *leje* mënjanoi sinonimin e saj *jë*, edhe kjo një fjalë formuar brenda sandhit (sh. *jë*). Për të tilla formime khs. *druese*, *kushtrim*, *mbase*, *shklata*.

*lemzë* f. II. "organi gjenital i gruas". Këtë fjalë të geg. veriore Gazulli (f. 204, 234) bashkë me formën *klemëz* të Malsisë së Lezhës e lidh me të drejtë me verbin *me le*. Nga të dy format, *lemzë* është e zgjeruar me kombinimin e sufikseve *-m* e *-zë*, ose është një zgjerim me *-zë* i formës participore *lēm*; *klemëz* është edhe përngjitur me *kë*; sh. dhe Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 73. Një formë e tretë e fjalës, *të lëtht*, që jep po Gazulli për Pukë, paraqitet si një deminutiv më *-th*, po mbetet e paqartë a është një neutër apo një plural. Forma *lemcë* "matrice degli animali" e Cordignanos është një variante e *lemzë*-s me sufiksën *-cë* (për *-zë*), karakteristik për geg. veriperëndimore. Sh. për këtë formant Xhuvani-Çabej, Prapshatesat 27v.

*lencúe* m. "çarçaf i dyshekut". Bashkë me kal. (te De Rada) *l'uncól'* vjen nga it. *lenzuolo*, G. Meyer 241, Sh. dhe Helbig 40.

Te Buzuku (LV/2=LXV/2b, LXVI/2=LXXXVI/2a, LIX/2=LXIX/2a) *linci* l, akuzativi *lincionë*, pl. *linci* j. Te Bardhi Linteolum *Lencue*, poashtu te Bogdani (I 126,5; 129, 10). Format me *-ue* rrjedhin nga singularizimi i pl. *lencoj*. Te Buzuku ruhet singulari i vërtetë *linciól*, poashtu në Kalabri *luncól'*, atje nën ndikimin e paprerë të italishtes; sh. Li. Posn. VII 196. Skoku (Revue des ét. slaves X 190) serbokr. çakav. *lâncun lincun*, pranë

formës më të rregullt *lincuo* gjenitiv *lincula*, e spiegon nga lat. *linteolum*. Për mendimin tonë edhe aty ka një huazim nga italishtja (venecianishtja) ose nga dalmatishtja, vegliot. *lenzul*. Pra edhe aty ka një fjalë romane, jo latine.

**lende**, *lënde* f., *lend* m. "kokrra e lisit". Spiegimin e G. Meyerit (f. 243) nga lat. *glandem* "lende" e pranon Puscariu EW 714 e Weigandi 47, e më parë edhe Jokli (Mitt. d. Rum. Wien I 303). Përkundrazi M. E. Schmidt (KZ 57, 22) gjen këtu një fjalë vendi të shqipes, e afër me *lëndë landë*. Mendim i pranuar te Jokli (IJ XV VII 195, te Walde-Hofmann I 603), veçse me disa rezerva ndaj spiegimit të raportit morfologjik midis *lend* e *lende* nga ana e M. E. Schmidit.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (L, Luka 15,16) *E dëshir kish barkëtë e ti me e ngingunë n lendijet qi thitë kullosnjinë* "Et cupiebat implere ventrem suum de siliquis quas porci manducabant"; Budi (SC 196, nën ndikim të Buzukut?) *sa dëshëronte barktë e vet me e mbushunë . . . me lend e me gjellë cë thivet*; Bardhi Glans, ghianda *Lend*. Nëpër dialekte ndrohet *maskh. lend* me fem. *lende lënde*, duke mbizotëruar e para në gegërishten, e dyta në toskërishten. Khs. për të parën, përveç dëshmive të fjalorëve të ditur, për geg. lindore Puljevski 48 *lënn*, për shqipen e Istriës *lëndit* (Nd. Mjedja, Leka IV 361); për të dytën përveç Kristoforidhit sh. dhe Çekrezin e Drizarin. Në Margëllëç të Çamërisë e në të tjera vise të Toskërisë *lënde*. Ashtu dhe arbërishtja e Sigelisë: te P. Skir i (Fjala e t'in Zoti) *dëshiroj të mbëloj barkun e tij me lëndet që hajën derrat*, mbase pas hullisë së Buzukut. Në gegërishten përdoret edhe *land* m. Ambigjeninë në singular Jokli (IF 36, 147) e spiegon me skemën nominativ-akuzativ, në mënyrë që *maskh. lend* është nominativi i ri formuar duke u nisur gjuha prej akuzativit. Për mendimin tonë (sh. Li. Posn. VIII 89) *lende* është ose plurali i singularizuar i *lend-it* ose një ndrim i këtij në një femërore më -e, siç janë ndër të tjera mjaft emra pemësh sipas tendencës së ditur të shqipes, sh. Li. Posn. VII 170 vv. Trajta *linde* e Gjirokastrës mundet të ketë dalë nga singularizimi i *lende-s*, ose thjesht fonetikisht prej kësaj, pas rregullës së ndrimit të grupit *en* në *in* para një konsonanti; *lëndre* e shqipes së Greqisë (te Furikis, 'Αθηνά 41, 122) është plural i singularizuar. Sh. për gjithë këto trajta Li. Posn. VIII 89.

Për etimologjinë çon në peshë fakti që kjo fjalë nuk shënon kudo vetëm frytin e lisit. Në Greqi *lënde lënde* pas Heldreichut 50 është kokrra e *Ecballium elaterium*; në Lunxhëri *lëndet e bredhit* e në Berishë *lannt e breut* janë thelpinjtë e boçës së bredhit; në Opar *linde* është thjerza; Bageri 34 ka *lan* "kokër thjeri". Nga këto të dhëna del se *lende* nuk ka ndonjë lidhje me *landë lëndë*, po do të thotë në thelb "kokër"; edhe formalisht *lend lende*, *land lënde* shihet se nuk është një me *landë lëndë*. Shq. *lend lende* "kokër" afrohet me lat. *lens lentis* "thjerrë", me sllav. kishtare *lesta* "φαρός" (baza e fjalës sllave *let'a*) e me gjerm. *Linse* gjerm. e lartë e vj. *linsi* "thjerrë"; sh. për këtë grup fjalësh sidomos Walde-Hofmann I 783, Vasmer REW II 84. Baza e fjalës shqipe \**lent-*. Specializimi i kuptimit nga "thjerrë" nëpër "kokër" në "lende" spieget me përdorimin e lendeve si ushqim, në Labëri pas Cyprien Robertit gjer në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, sh. shtjellimet e Joklit LKU 179. Edhe sot nëpër malësitë e Veriut lëndet zëvendësojnë nganjëherë bukën si ushqim.

**lenó**j "lehtësoj (një dhimbje, një sëmundje); ngushëlloj"; *lenohem* "lehtësohem; letohem, bëhem matuf, meshnohem". G. Meyerit 244 e jep si *lënoj* dhe e spiegon prej lat. *lenire* "me zbutë, me lenue". Pokështu Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1048 dhe Helbigu 49. Weigandi 47

përkundrazi lëkundet midis lat. *lenis lenire* e it. *lenire*. Kamarda I 173 e gjente të gjashme me fjalën latine.

Fakti që verbi latin nuk ka vazhduar si fjalë popullore në gjuhët romane e bën të dyshimtë etimologjinë latine të fjalës shqipe. Si formë e gëgërishtes kjo është një rrjedhojë verbale më *-(ë)noj* e formës së vjetër *i lē* për të sotmen *i lehtë*. Këtë burim e vërteton dhe gjatësia e *e*-së të *lēnoj*, që pasqyron vokalin e gjatë të *i lē* nga ka buruar. Prej lat. *lenire* nuk spiegotet kjo gjatësi. Edhe afrimi në kuptim me *letoj* e me të tjera rrjedhoja të *i lehtë* flet në të mirë të këtij spjegimi. Nga *i lē* duket të rrjedhë dhe *lejsongj* që jep Kristoforidhi për të folët e Përmetit.

**lentónj** "krijoj". Fjalë e dialektit të Borgo Erizzos në Dalmaci, te Tagliavini 56. Siç tregon Jokli (Archivum Romanicum XXIV 13), është një denominativ me *-(ë)tonj* i *landë*-s, baza një \**lënd(ë)-tonj*. Grupi *nt* nuk u asimilua më në *nd*.

**lep, lepe** "urdhëro"!, përgjigje që i jepet një më të madhi, kur na thërret. Mungon te G. Meyerit; e ka sëpari Junggu, si *lepe* "comandi, parli". Nga turq. *leppey lebbeyk* "gati, urdhëro". Turqisht është edhe përgjegjja *peqe* "mirë" (sh. këtë fjalë). Gabim Gazulli 234: serbokr. *lijepa* "bukur".

**lepër lepra** f. "gërbulë"; *leprosem* "gërbulem". Pas G. Meyerit 241 nga gr. e re **λέπρα λεπρώνω**.

Për këtë sëmundje Buzuku përdor forma të fjalës *fëlliq* pranë kësaj fjale; p.sh. (XXXVIII/2, Mateu 8,2) *e hinje një qi kish leprënë, sin e atë adoron* "et ecce leprosus veniens adorabat eum". Bardhi *Lepra Të fëllijm*. Në Veri kjo fjalë, që s'është popullore (popullore janë *gërbulë* e forma të *fëlliq*), ka shumë më të gjatë të ketë hyrë prej lat. *lepra* me anë të kishës sesa prej greq. së re. Për toskërishten burimi grek është më afër menç. Meqë për *lepër* toskërisht thonë *lebër lebrë* (Kristoforidhi), me këtë fjalë gjan të jete identike *lebë* f. "sëmundje e lëkurës me qelb në krye të foshnjëve" në Ndroq. Mbase hyn këtu edhe *lebër* f. "një farë sëmundje në gji të gruas që shkaktohet nga mbështjellimi i qumështit". Trajta *lebë* spiegotet nga veçimi i *r*-së fundore, duke u marrë kjo në ndjenjën gjuhësore sikur t'ishite formanti *-r*-. Gabimisht Kavalioti gr. **λέπρα** e përktheu me *frënguzë*, sh. G. Meyer Alb. Studien IV 78.

**lerë** f. II. "zhul, zdral"; figurshëm "njollë, turpe, dhunë"; *lerós* "ndyj, zhyj". Pas G. Meyerit 238 nga gr. e re **λερώνω** "leros" e kjo nga gr. e vj. **ἀλαρῦναι** **ρουπάναι**, po edhe **όλερόν** **βορβορώδες**, **τετραγμένον** e **άλέρον κόπρον**, të gjitha te Heziku. Për fjalën shqipe ndjek këtë rrugë dhe Lambertzi KZ 53, 292; për fjalën greke Hatzidakis KZ 27,70 e Andriotis 123. Khs. dhe O. ir. Arhiv za arb. starinu II 287.

Është edhe emër katundi (*Lera*), me banorë shqiptarë toskë, në rrethet e Manastirit (Skok, Glasnik Skopskog učenog društva 2, 1927, 287). Fjalë thjesht shqipe. Ka dalë poashtu nga *lyej* si *plerë* nga *vyej*, *shqerrë shqerrëz* nga *shqyey* etj.; sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1961) 180. — **λέρα** është një nga jo të pakat elemente shqiptare të greq. së re. Po shohim tani se këtë mendim e ka pasur sëpari Kamarda (I 146, II 151). Veçse nuk mund të pranohet me atë një zhvillim fonetik *lier*: *ljerë*: *lerë*, po kemi një të atillë si te *plerë*, *shqerrë*. Kuptimi i ndyrësisë del shpesh nga ai i të lyerit; khs. shq. *i kam duart të lyera* për "të ndyta", gjerm. *Schmutz* "lerë" e nëpër dialekte "lyrë" etj. Khs. dhe *përlyej*, te Bogdani (II 68, 17) *të përlyna* "sordide". Ndërkaq mundet që *lros* të jetë formuar brenda shqipes nga *lerë* ose të jetë gr. e re **λερώνω**, denominativi i **λέρα** -s.

Nga kjo dhe të *lerósura* "të ndyta" në shqipen e Greqisë, shënuar te Weigand Balkan-Archiv II 171, 212. Sh. edhe *lerë* III., *lesë*.

**lesë** f. "rreckë e lyer me të cilën pastrojnë". Fjalë e geg. veriore, te Cordinano. Është një postverbal me *-së* prej *lyej*, ashtu si *fshesë* prej *fshij*, *ndjesë* prej *ndjej* etj. Lidhet prandaj më tej me *lerë* II. e *lesë* III. Një kompozit i *lesë-s* me për është *përlesë*. Sh. edhe *lečkë*.

**leskër** f. "petë që ndahet prej faqes së murit, prej një minerali a prej kores së bukës, kërcë; pare peshku"; *leskëroj* "bëj leskra-leskra", *leskërohem* "bëhem leskra-leskra, ripem". Mungon te G. Meyeri, del sëpari te Junggu e te Bashkimi për "escrescenza". Huazim krahinor nga serbokr. *liska* "paftë, petëz e hollë metali", që tani është përgjithësuar në gjuhë. Sufiksi *-ër* si te *flatër*, *flokër* etj.; sh. për këtë Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 41.

**lesh** m. n. I. "leshtë e bagëtisë; leshtë e kresë, flokët"; i *leshtë*; *leshtëk*, *leshtën*, *leshtëor*. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri më parë (Alb. Studien I 40) e afronte me sllav. e vj. kishtarë *vlasъ* "capillus"; po më vonë (EW 241, Alb. Studien III 24, 38, 61), duke e çuar te një bazë \**tleusos*, e krahason me fjalën gjermanike ags. *fleos* gjerm. *Vlies* "bashkë leshi". Mendim i pranuar te Weigandi 47, po përndryshe i lëftuar kudo. Jokli (Studien 49 v.) bën një lidhje me ind. e vj. *lava-h* "të prerët, gjë e prerë, qethë, lesh, flokë; copë", *lavi-h* "drapër," gr. *λαῖον* mbase "drapër"; baza e *lesh-it* sipas tij një \**leu-s-*, duke u lidhur kjo fjalë përbrenda shqipes me *letë*. Etimologji e pranuar me rezervë te Walde-Pokorny II 407 e pa rezervë te Walde-Hofmann II 325, Pokorny I 681. Edhe Bariçi (I 45) bashkon *lesh* me *letë*, po atë e përqs me lat. *lana*, gr. *λῆνος*, , got. *wulla*, lit. *vilna* "lesh", osv (Hymje 26) me gr. *λάχνη* "flok kaçarrel" *λάχνος* "lesh", duke e spjeguar *sh-në* e fjalës shqipe nga një *ks*. Poashtu me gr. *λάχνη λάχνος* e afron *lesh-in* Vasmeri (Studien I 38 v.), duke përfshirë në këtë barazim dhe grupin gjermanik të isl. *lǫ* dan. *lu* "push i cohës" nord. e vj. *wlch* "flok". Si kemi shënuar dhe te Bul. i Shk. Shoq. 2 (1954) 44, afrimi i *lesh-it* me gr. *λάχνος* gjindet që te Kristoforidhi 205. Sëfundi Ribezzo (Riv. indo-gr.- it. I 16) e krahason fjalën shqipe me gr. *Φλάσιος* "leshatak, tufshak".

Fjalë e mbarë gjuhës. Sikundër e kemi shtjelluar te Bul. i Shk. Shoq. 3 (1955) 42 v.. nuk është një neutër i vjetër, siç kujtohet përgjithësisht (khs. sidomos Pedersen KZ 34, 287), po një mashk. pl. *lesh-të* që u muar për neutër e u bë pjesërisht dhe i tillë. Kjo shihet nga dëshmia e autorëve të vjetër: Buzuku (XII/2, Psalm 147, 16) *Aj ep bdorenë porsia leshnë* "Qui dat nivem sicut lanam", Budi (SC 92) e *leshi kūr qethetë* (292 të *leshtë*). Nga rrjedhojat e fjalës do vënë re sidomos denominativi pa mbaresë *leshem*, faktitivi *leshtohet peri* e emri botanik *leshnje* f. "myshk" (Delvina), me *-nje* si *myshnje* "myshk", *shelnje* "shelk". Për etimologjinë do shënuar se përdorimi shpeshherë si plural i fjalës paravendur që *lesh* të jetë një formë metafonike, një plural i sing. ilarizuar, e që singulari i hershëm të ketë qenë \**lash*. Kjo formë, si refleksi i një baze \**vlaks-*, ka të gjarë të jetë e a'ër me gr. *λάχνη λάχνος* nga \**λάκισνά* \**λάκισνος*, paragreq. \**vlksnā*, sllav. e vj. kishtarë *vlasъ*, avest. *varasa-* pers. e mesme *vars* "lesh, flokë" etj.; ose e afër me gr. *Φλάσιος*, si mendon Ribezzo. Në rasën e parë *sh-ja* e *lesh-it* ka dalë nga grupi *ks*, në të dytën nga një *s*. Në qoftë se *lesh* piget me *Φλάσιος*, bie spjegimi i fjalës greke nga një \**Φλάτ-ιο-ς*, si mendohet sot përgjithësisht. Në çdo rasë *lesh* është një nga ato fjalë të shqipes ku *l-ja* nistore është refleksi i grupit *vl-*. Sh. dhe *leshnik* te *loznik*.

**leshkorrë**, *leshkorre* f. "gruaja që pret flokët kur i vdes burri, në shenj

se nuk do të martohet më". Kjo fjalë, që mungon te G. Meyeri, është një kompozit *lesh-korrë* "ajo që ka korrë, ka prerë lesht'e kresë", Weigand 47. Në Labëri ka dhe *bishkorre bishkorre* "pela së cilës i pritët bishti në shenjë zie, kur i vdes i zoti". Fjala *κουριμαδιά* "grua e ve" në dialektet veriore të greq. së re për mendimin tonë qëndron për: *κουριμαλλιά* (*κουρεύω* "qeth" e *μαλλιά* "flokët") dhe është një përkthim i fjalës shqipe, po me rendimin grek të dy pjesëve të kompozitit.

*leshnjane* f. "erë e verilindjes". Pas Cordignanos "kështu i thonë në krahinë të Shkodrës erës që fryn nga Gryka e Lezhës". Është trajta femërore e *leshnjan-it*, pra substantivimi i (erë) *leshnjane*, prej *Lesh-it*. Për përdorimin e emrave gjeografike si emra erërash sh. kohët e fundit H.R. Kahane, Toponyms as Anonymyms, te revista Names 5 (1957) 241 vv.: *vento greco, άνεμος λιβυκός, vento de Provenza* etj. Nga fusha e shqipes khs. (*fryn*) *Vlora* "era e veriperëndimit" në Jugë. Edhe *shkupë* f. "erë e nxehtë që shkrin borën" te Fjal. i gju. shqipe pas gjase është "erë e Shkupit".

*levrek* m. "Morone labra, emër peshku", Pas G. Meyerit 233 (te *labrik*) nga gr. e re *λαβράκι*; pokështu Manni 243. Në të vërtetë nga turq. *levrek*, kjo prej greqishtes, po zhvilluar me harmoni vokalike. Për fjalët greke që kanë shtektuar me trajtë turke sh. *dërhem, efendi, kallëp*. Drejt-përsëdrejti prej greq. së re rrjedh tosk. jugore *lavrah*.

*lez* m., *leze* f. "nishan i kuq në fytyrë a në trup". Fjalë e gegërishtes, që mungon te G. Meyeri. E ka Kristoforidhi me kuptimin më sipër, Junggu e Bashkimi si *lez* m. "macchia o altro segno esteriore un pò prominente venuto in qualche parte del corpo, voglia". Tagliavini 170 v. jep për të folët e Borgo Erizzos *lemz-a* f., të cilën e afron me format *lez lezë* të Shqipërisë, po duke e lënë pa spjegim etimologjik. Jokli (Archivum Romanicum XXIV 31) sheh te këto fjalë një postverbal të *lej* "lind", te *lezë* një zgjerim nga participi *le*, te *lemz* një të tillë nga participi *lemë*, e te *-zë* një sufiks kolektiv. Kuptimi i parë sipas tij "shenjë që prej së leri", si angl. *birthmark*, frgj. *marque de naissance*, it. *nascenza*.

Forma *lez leze*, etj. është sinonimi i *lyth-it*, e për këtë Bogdani ka *lye* "macula". Shihet se këto fjalë rrjedhin të gjitha nga *lyej*. Shenjat në trup quhen shpeshherë "njollë"; prej "lyej, ndyj" kalohet në "njollë", prej "njollë" në "shenjë në trup, nishan". Nga dy sinonimet, *lyth* është një deminutiv më *-th*; *leze lez* një deminutiv më *-zë*, prej formës verbale me *-e-sic* del te aoristi *leva*; khs. *krye*: *kezë* prej *\*krezë*. Forma *lemz* e Borgo Erizzo *-m-në* e saj ose e ka prej të *lyem* (te Tagliavini 171) ose e ka marrë me rrugë analogjike. Sh. tani Bul. Univ. Shtet. të Tiranës Seria Shk. Shoq. 4 (1961) 180.

*lë* lã, *lashë, lënë lanë; i lanun* "i lëshuar", *i lënë* "i marrë", në Itali *lënësi* f. "marrëzi". Që prej G. Meyerit (f. 242, Alb. Studien III 65, 82, IV 24) e këtej e vëndojnë te grupi i got. *lëtan* gjerm. *lassen* "me lanë", nord. e vj. *latr* "i plogët, përtac", lat. *lassus* "i lodhët, i këputur" etj.; khs. Weigand 45, Jokl LKU 252, Walde-Pokorny II 395, Walde-Hofmann I 768, Pokorny I 666. Baza për *lë lã* pas G. Meyerit *\*lad-nō* *\*läd-nō*, për participin *lënë lanë* një *\*lad-ño-* *\*läd-no-*. *\*lanno-* Brenda shqipes pas Meyerit lidhen me këtë fjalë emrat *lëbarke lëbarqë*-*\*lanni-f.* "purthë, bark i keq" e *vilani* "alivan" dhe verbi *lodh* (sh.këto fjalë). Barazimi *lë*: got. *lëtan* gjindet që te Boppi 530.

Fjalë e mbarë gjuhës. Participi tosk. *i lënë* përdoret për "i marrë", sidomos në arbërishten e Italisë, geg. *i lanun* "që e lë vetën pas dore, i shkujdesur". Si kemi shënuar te Bul. i Shk. Shoq. 4 (1953) 33, nuk është mundur që *lë* e *lënë* të kenë rrjedhur prej dy bazash *\*ladnō* e *\*ladno-*, të cilat kanë të njëjtin grup fonetik në trup fjale dhe ndryshojnë vetëm në vokalin fundor.

La Piana (Intorno alla vocale "o" lunga etj. 25 v., Studi ling. albanesi I 34v.) sheh në participet më -në edhe në toskërishten, si *lënë, dhënë*, participate të hershme më -t-, pra p.sh. të *dhanë dhënë* një \*danta \*danda \*dhanna, e krahasueshme me gr. **δοτός**, dhe në e kemi ndjekur gjer diku këtë mendim në vendin e cituar. Tani e shohim të padrejtë që për disa pak verbe më -në si *dhënë lënë qenë* të pranohen forma me -t-, të cilat në shqipen paraqiten ndryshe (*ratë, thatë*). Te këto verbe n-ja dhe në toskërishten rrjedh nga -nn-, ku njëra n është e temës (janë tema nazale), tjetra e participit. Pra dhe këtu kemi participe më -n-, e cila në këtë mënyrë nuk u rotacizua si te *lerë, parë* etj. Për kuptimin do pranuar me G. Meyerin që fjala e shqipes afrohet nga kjo anë më fort se me të tjerat me gjuhët gjermanike. Po sa për formën, për mendimin tonë nuk është nevoja të kërkojmë te *lë lã* medoemos një zgjerim me dental -d- si te gr. **λαθεῖν** lat. *lassus* got. *lētan* etj. Shq. *lë lã* shpiten te një \*lan, si *shullë shullë* te lat. *solanum*; ose çojnë te një lon- (kjo mundet nga \*lēn-), si *zë, zëri, zã zani* = sllav. *zvonъ*. Kështu *lë lã* mund të afrohet nga forma me lat. *lenis* "i butë" ose me sllav. e vj. kishtarë *lenъ* "i plogët", e të jetë refleksi i një baze \*lan- ose \*lon- nga \*lēnō.

**lëbyrem:** më janë *lëbyrë sytë* "më kanë vënë sytë perde"; *lëbyr* m. "perdja që vënë sytë, prask". Fjalë e Shqipërisë së mesme, që mungon te G. Meyeri; e ka Logoreci e Manni. Do zbërthyer në *lë-b-yrem*, ku pjesa rrënjore është një me *irem* "nxihem" i *irun* "në bojë plumbi si më të zezë", me ndrim të i-së në y pas okluzivit labial. Formanti *lë-* del dhe në verbe, si te *lmehem lmbarem lgjirem*, sh. Xhuvani-Çabej Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 79. b-, prefiks, zakonisht nominal, këtu i është ngjitur një verbi.

**lëfore** f. "lëkura e disa pemëve, si rushi, portokalli"; **lëforë** f. "pare peshku". Mungon te G. Meyeri. E jep Weigandi si *lifor-a* "pare peshku", pa spjegim etimologjik. Është një formë e fjalës *lëvore livore* që trajtohet te *lëvere*. Spiranti *v* shurdhohet nganjëherë në gegërishten në trup fjale, khs. *rrudã: rrëfanë*. — Një zgjerim i *lëfore-s* gjan të jetë *lëfoshtër*. Sh. dhe *lëfosë*.

**lëmehem** "nismë, stolisëm, vë të kuq e të bardhë". Fjalë e kozmetikës së gruas; përdoret në Tiranë, mungon nëpër fjalorë. Gjan të përfaqësojë një *lymehem* e të ketë dalë nga participi *lym-* i verbit *lyej*, khs. *gruaja lyhet*. Kjo fjalë është mjaft e degëzuar në shqipen. Aty hyn sëpari *lëmës* "marr me të mirë, përkëdhel", khs. frazën *të lan të lyen* "të gënjen me lajka". Pastaj *mëlmëj* "i shtie gjellës yndyrë, lyrë, vaj" bashkë me emrin *mëlmesë* f. e me *i mëlmym*, *i mëlmjeshëm*. Sh. këtë, khs. dhe *bulmët*.

**lëmë, lamë** f., çam. it. -shq. *lëm* m. "shesh i gatitur për të shirë grurin; të shirët e grurit; gruri i shirë"; *lëmi* i *parë*, *i dytë*; koha e të shirit, korrik, gusht". Pas G. Meyeri (f. 243, Alb. Studien III 77, IV 118), fjalë e afër me sllav. e vj. kishtarë *lomiti* "me thye", *lomъ* "e thyer, copë" serbokr. *lemati* "me rrahë, me sqaqë në dru" etj. Etimologji e pranuar me rezervë te Berneker I 731 v., Walde-Pokorny II 433 v., Pokorny I 674, Vasmer REW II 56.

Fjalë e mbarë gjuhës, me -ë e pa -ë, mashkullore e femërore. Plural kudo me shpërngulje të theksit, tosk. *lëmënj* (kështu dhe në Greqi *lemënje* Reinhold 8, në Siqeli *lëmënjë* Kamarda I 199); geg. (Bogdani I 137,3) e *kanë me u mbushunë lemanjëte grunë* "et implebuntur areae frumento" pranë fem. ndë mjesditë *Lamësë thatë* "in mezo della secca Terra" (II 14,9); sh. dhe I 104,4; II 65,10. Kjo ambigjeni në singular mbase është një shenjë që emri gjatë një faze të shqipes ka qenë një neutër; në këtë drejtim duket të flasë dhe ë-ja fundore e *lëmë-it*. Buzuku nuk e ka; në të vetmin vend ku del lat. *areae* (LXXI/2=LXXXI/2a), ai këtë, nën ndikim të analogjisë formale

me shq. *arë*, e jep me këtë fjalë. — Kuptimi "rrotullamja e mullirit të vajit; koha e shkëljes së ullinjet" (edhe te K. Gurakuqi, *Illyria I* Nr. 29 f. 8) shihet dhe në gr. *ἄλωή*, që bashkon kuptimet "lëmë" e "vend me vreshta"; khs. dhe në *lamë te pemet* "në kohën e vjeljes së pemëve". Përdorimet *lama e luftës*, *lama e druve* "fusha e druve", *me e bā lamë* "me e mëshi prej faqes së dheut", *një lëmë gjak*, *lëmi i shkallës* "kryet e shkallës" dëftojnë se fjala ka pasur një kuptim më të përgjithshëm "shesh, truall i hapët" që u specializua në atë të lëmit të arës; të tjera përdorime të Lambertzi 103. — Rrjedhoja: *lamth* m. (Vis. e Kombit II, 1, 124), *lamzë*, adverbialisht në *u mbush lamzë* "u mbush për buzë", e para nga mashk. *lami*, e dyta nga fem. *lama*.

Etimologjikisht *lamë lëmë* — si e kemi shtjelluar në Studii si Cere. *lingvistic X 4* (1959) 556 v. — do afruar me lit. *lomā* "vend i ulët në një arë", let. *lama* "vend i ulët, vend gropë në një arë, gropë, hurdhë", të cilat i lidhin prej kohësh me lat. *lama* "llogaçe, pellg, ligatë, vend batak" (e kundërshton Fraenkel 385). Pas shtjellimit të C.H. Balmorit (Emerita 4,74 vv., sh. Walde-Hofmann I 870 v.) *lama* është në latinishten një fjalë ilire, sikundër shihet dhe nga përdorimi i saj te Ennius e te Horaci që rrjedhin prej trevës mesapike. Me këtë përkon përhapja e fjalës *lama* sot në Apuli e në toponiminë e Italisë më fort në krahinat dikur ilire, në Dalmaci e në Liguri, siç tregon Balmori në vendin e cituar; khs. edhe R.P. Pidal (Z. f. r. Phil 59, 202 vv.), Rohlf (Archiv f.d. Stud. d. neuer. Sprachen 184, Heft 3/4, shkurt 1944, f. 104; Veneti, Toskanë, Umbri, Abruce, Apuli), Kretschmer (KZ 69,5 shën. 1), J. Hubschmid (Bol. di Fil. 12, 137 v.), G. Alessio (Word 7,34). Prej toponimisë ilire hyn këtu pas Krahes (Die Sprache der Illyrier I 93 shën. 234) *Λάμπος* në Bruttium e *Lamatia* në Iliri me gjithë emrin etnik *Λαμητινῶν Lamatini*. Sh. tani së fundi dhe vrejten tona te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës *Seria Shk. Shoq. 4* (1962) 120, 137. Lit. *lomā* K. Buga (KZ 51, 122) e lidh përbrenda gjuhës me *limti* "me thye". M'është tjetër Jokli (te Walde-Hofmann në vendin e cituar) me fjalët baltike afron disa forma të gjuhëve fino-ugrike si fin. *lampi* "liqen i vogël, hanz", est. *lomm* "pellg, llogaçe, vend i ulët në arë", etj., për të cilat sh. edhe Vasmer në vendin e cituar.

**lëmsh lamsh** m. E kanë spieguar më parë nga një lat. \**glemus* për *glomus*; khs. G. Meyer (f. 243, Alb. Studien IV 71), Sommer IF 11, 334, Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1055, Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 29, 36), Puscariu EW 711, Weigand 45, Jokl LKU 23v., Bariç Arhiv za arb. starinu II 80, Rosetti Ist. li. rom. I 61. Vetëm Treimeri (Slavia III 451) e Jokli më vonë (te Walde-Hofmann I 609) e kundërshtojnë etimologjinë latine, me vrejten e drejtë që grupi nistor *gl-* do t'ish reflektuar nëpër dialektet e shqipes me *g-* *gi-* *gj-* *gl-*. Treimeri e afron fjalën me sllav. *lomiti* "me thye", duke u nisur prej një kuptimi "kërcu" e duke krahasuar për semantikën gjerm. *Kloben* "kërcu": *klieden* "me çu"; Jokli përveç etimologjisë latine lëfton dhe afrimin me irl. e vj. *loman* "gjalmë" që bënte M. E. Schmidt (KZ 57, 20); si *lëm-sh* e bashkon brenda shqipes me *lemaje* (*lem-aje*) "hark, qemer".

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Bardhi 213 *Mer pēnē ndē do me gjetunē lamshinē* "Piglia il dritto, se voi trovar il torto". Përveç lëmshit të penjëve shënon dhe çdo trup rrumbullak e gogliq: *lëmshi i dheut*, te N. Frashëri (Ist. e Skëndërbeut 31, varg 1007) *lëmsh'i djellit*; Mitko 81 (figurshëm) *kam një lëmsh ndë zemër*; Reinholdi (Glosari 19) *i bërre lëmsh*; në Gjirokastër *lëmshet* "testiculi" (në të shara: *më rruan lëmshet!*). Në arbërishten e Chieutit në Itali *lëmshet*, me -t fonetike si te *mes* për *mest*. Plurali tosk. *lëmshë* e *lëmshinj*,

te Drizari 59 me metatezë *lëshminj*. Morfologjikisht *lësh* është një deminutiv me *-sh* (Jokl, Tagliavini 168), jo një nominativ i vjetër me *-s* (Meyer-Lübke), as një ablativ a lokativ i fosilizuar më *-sh* (Spitzer, Mitt.d. Rum. Inst. Wien I 324). Fjala e shqipes ka depërtuar si *ljomçe ljameç* dhe në dialektet serbokroate (Skok, Lengvist. prouçavanje 215). — Nga spjegimet e gjertanishme asnjëri nuk është drejtë. Etimologjia latine përjashtohet a priori. Krahasimi me sllav. *lomiti* nuk ecën, kryesisht për arsye kuptimi. Afrimi me *lemaje* ndesh në rrethanën që kjo e fundit është një kompozit i *majë-s* me *lë*-, sh. Xhuvani-Çabej Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 79. *lëm-sh lam-sh* si "send rrumbullak" lidhet përbrenda shqipes me *valë* e me *vjell*, e në rendin indoeuropian me ind. e vj. *válati* "sjell, dredh", gr. *εἰλέω* "rrokulloj, rrotulloj", lat. *volvo*, gjerm. e lartë e vj. *wellan* "me rrokulloje", sllav. e vj. kishtarë *valiti se* "κυλίεσθαι" etj. Baza e fjalës shqipe afërsisht një \**ulo-m-*, \**vlo-m-*. Në shqipen *v*-ja nistore e grupeve *vl- vr-* bie, sh. *lag, lesh, re, rë, ruaj, rrej, rrënjë*.

*lëndoj* "vras plagën; gandoj"; në dialektin e Greqisë "prek plagën, vë gishtin në plagë". G. Meyeri 244 e lë pa spjegim; në Alb. Studien V 92 mendon për një afrim me *lindë, i lintë*, si të thuash "prek me një beze liri".

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Budi (DC 88, 130) *e kã lënduom e trazuom mbë mënj*; *e ashtu ende psikundrëse malcon plaga, e fëshitir shëndoshetë mbatëherë kūr e lëndon herë pas here*; poashtu SC 24, 25. Boçari ka dhe *lëndim*, Kristoforidhi *lëndi* f. "mëri", *kan lëndi me atë*. — Spjegimi nga i *lintë* përjashtohet a priori. Mund të jetë një huazim nga lat. *laedo laedere* "lëndoj", me një epentezë popullore të një *n*-je, shtesë mjaft e vjetër, sa që ndaloj zhdukjen e *-d*-së intervokalike. Ky mendim duket të jetë më afër meç sesa të shihet te *lëndoj* një fjalë autoktone e shqipes, e afër me fjalën latine, me gjithë se nuk përjashtohet dhe kjo mundësi. — Sh. dhe *lëndi*.

*lëng lang m*; *më lëngëzon goja; rrusht pak skal'angur* "uve semimature" te De Rada. G. Meyeri 244 kujton *lanco* "brodo" në një gjuhë të fshehtë të Italisë veriore, po në Alb. Studien IV 52 mendon — me dyshim — për një afrim me gr. *λέμφορ* "qurrë, jargë", afrim që nuk është pranuar.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Bardhi Iusculum, Brodetto *Lang*, Iurulentus, *cotto con brodo Ziem ndë lang*, f. 208 *E dogj langu bushtërrë* "Ha bruggiato il brodo la cagna". Nga rrjedhajat emërore khs. *lëngësirë, lëngëshirë, lëngëshitirë* "ujthi i drurëve, i pemëve" (Tase), geg. *langsinë langcinë; lënguth m*. "lëngu i drurit të njomë" *lëngëzohet* "ka nisur të hypë lëngu në trung të pemëve", *me langue* "me qitë lang (Gazulli), *langët* "lëngëzohet", *langës* "i ujshëm" (*dardhë langëse*), *langshton* (plaga) "ujcon plaga", *langtyrë* f. "spirilang" (me ndikim të *latyrë-s*). Nga kompozitet nominale e verbale khs. *langshtrydhe* f. "dredhëz, luleshtrydhe", *spirilang m*. "latyrë" e *përllangem* "ndyhem (me gjellë, me baltë etj.) në Dibër, kjo me velarizim "ekspresiv" te likuides. — Etimologjikisht *lang lëng* mund të jetë një me verbën *lag*, me epentezë të vjetër të një *n*-je. Shpeshherë qullet, lëngjet e kanë emrin nga të lagëtit; khs. rus. *vologa* "lagështirë; gjellë e lëngët, lëng" (Vasmer REW I 219), gr. *ὄργος* "i lagët" e "i lëngët". Nga shqipja vetë khs. dhe *lëngatohen* "ligatohem, marrin ligatë dhentë". — Arom. *lânguta* "pikë, një pikë ujë" nuk rrjedh nga *lagëtë* (Capidan, Rev. filologica II 106 v.), po nga *lëng*, (i) *lëngët*. Kështu tani dhe Papahagi 615.

*lëngór* "i përkulshëm, i epur". Këtë fjalë të de Radës G. Meyeri 244. e vendos — me dyshim — te *lëngo*j. Jokli (Studien 50) e afron me lit. *lenkiù lenkti* "përkul, lakoj", sllav. e vj. kishtarë *lesti* "me përkulë" *lokë* "hark", gr. *λοξός* "i përdredhur, i shtrembët". Pranuar te Berneker I 708, Walde-Pokorny II 435, Vasmer REW II 82, me literaturë.

Fjalë dialektore, që s' del gjëkund në burimet e vjetra, as në të folët e arbërishtes s'Italisë. Është një zgjerim me *-or* i *lëng-ut*, me kuptimin "i llojit të lëngut, si lëng". Një i tillë zhvillim semantik shihet dhe në të tjera gjuhë: gr. e re *ύγρός* "i lagët, i lëngët; i butë, i njomë, i përkulshëm". Nuk përjashtohet mundësia që të jetë një sajim i de Radës, i cili ka shpikur dhe disa të tjera fjalë, sh. *limoní*.

*lëpéc* m. "kau rrozg që s' duhet më; njeri shëndetlig". Pas G. Meyerit 248 një zgjerim i *lopë-s* me *-ec*, si *burrec*. Poashtu edhe Jokli.

Nuk ka të gjarë që kau plak ta ketë emrin prej lopës. *lëpéc* është "kau me lapë të varur", pra një zgjerim i *lapë-s* me *-ec*, sufiks shpeshherë me kuptim pejorativ o gjithsesi ironik: *burréc*, *ganéc*, *gavéc*, *tutéc*, sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 33.

*lëpjetë* f. "Rumex"; *l. e egër*; *l. e butë*; *l. bjeshke* "Rumex acetosa". Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyerit (f. 240, Alb. Studien V 92) i mbahet spjegimit nga një lat. *lapathum* = gr. *λάπαθον*. Thumbi (IF 26, 14 v.) e shpie fjalën pandërmjetësisht te gr. e vj. *λαπάθη*, po nuk lë pa theksuar vështirësinë fonetike, gr. *a*: shq. *je*. Etimologjinë e tij e pranon dhe Jokli LKU 119,208.

Kjo vështirësi fonetike, më të cilën ngul këmbë edhe Bariçi (I 93 shën. 1), flet në mënyrë të prerë kundra burimit të fjalës shqipe prej greqishtes; aq më shumë, kur nga trajtat e greq. së vjetër, *vitale* është treguar vetëm *λάπαθον*, khs. edhe Rohlf's EW 1249. Më anë tjetër as latinishtja nuk mund të jetë gurra e fjalës: trajta latine që vazhdohet në gjuhët romane është *lapathium* (REW 4897), e kjo do të kish dhënë në shqipen diçka si \**lëpasë*. Kështu *lëpjetë* e gr. *λάπαθος* *λόπαθον* *λοπάθη* pas gjase rrjedhin të dyja prej një baze të përbashkët mesdhetare, khs. Revue de Linguistique VII 1 184, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 125,141.

*lëvere* *livere* f. "rreckë; pëlhurë si rizë që vënë fshatarët në krye"; pl. *lëveret* "këmishët, ndresat", në Shpat edhe "ajkë, kajmak"; figurshëm "lëpushkë, gazetë e keqe", *lvete fiku* "lëvorja e hollë e fikut" (Gazulli), te Junggu *lvete* "fik i thatë"; *liveret* pl. "këmishët, ndresat" kal. (Santori) *l'iverezë* f. "shami për hundë", te V. Stratig i *l'ivere* "lëvere" I. Ferrari — K. Kamsi te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës Seria Shk. Shoq. 1 (1959) 84, 90, G. Meyerit 244 këtë fjalë bashkë me *lëvorë* f. "lëkurë, guaskë" e spjegon — me rezervë — më fort nga lat. *velarium* "perde e skenës", me rrugë metateze, sesa nga gr. *λοβός* "guaskë, lëkurë, kore". E kundërshton Pedersen KZ 33, 538.

Fjalë e mbarë gjuhës. Përdorimi metaforik dhe te N. Frashëri (Qerbelaja 170): *i bën armikët lëvere*. Nuk ka dyshim se *lëvere* *livere* afrohet me *lëvore* "gjethet e kalliu të misrit; lëkura e pemëve (e portokallit, etj.), e pjeprit, e kastravecit, e zarzavateve; lëkura e drurëve". Veçse spjegimi i tyre nga lat. *velarium* është i pamundur, për arsye të formës e të kuptimit, aq më shumë kurqë fjala latine nuk ruhet as në gjuhët romane. Kemi të bëjmë me një fjalë vendi. Me dy format verbale *var* e *gjërr* *virem* janë formuar me anë të kompozimit me *lë-* (*la-*, *li-*) një tok fjalë, shumica emra: prej *var* *lavar* *lavare*, *galasër*, *lavrak*, *lëvare* *livare*, *livarës*, *livarzë*, *kalivare*, *vastak*. Prej *sjerr* *virem* kanë dalë *i lëvirem*, *lëvirë*, *lavire*, *lavjerc*, *lifqer*, *lëvozhgë*, *lifore*. Nuk mund të hyjë *lëvere* me *-e*-në e saj te ky grupi i fundit. Forma e saj e cilëson atë si pluralin metafonik të një *lëvar-i*, i cili rron vetëm te *lëvare* *livare* f. "katarakt, ujvarë", kështu që sing. (i rrallë) *lëvere* *lëverja* paraqitet si një plural i singularizuar. Forma *lëvore* *livore* përkundrazi ka dalë me *lë-* prej *sjerr*, po prej aoristit *vara*, ashtu si emri topik *Vora* (sh. këtë). Prej *lëvore* edhe deminutivi *lëvorzë*, e verbet përkatëse *lëvoroj* e *lëvorzoj*

”qëroj, i heq lëkurën”. Format me *li-* (*livere* kal. *l'iverezë, livore*) kanë rrjedhur nga ndrimi i shpeshtë (sidomos në gegërishten, po edhe në toskërishten) i *ë-së* në *i* në silabë paratheksore. Për kuptimin e *lëvere-s* nga ”varem” khs. p.sh. frgj. *pendeloque* ”rreckë”: *pendre*.

**lëvozhgë** f. ”lëkura e vesë, lëkura e fortë e arrës, e lajthisë, lëkura e disa pemëve si portokalli”. G. Meyer i 476 jep për këtë fjalë format *olezgë vëlockë lëvezgë lëvoçkë livozhgë*, dhe sheh aty një huazim prej sllavishtes, sllav. e vj. kishtarë *lуска* serbokr. *ljuska* ”lëvore, lëvozhgë; pare peshku”. Selishçevi me të drejtë nuk e shënon këtë ndër huazimet sllave të shqipes. Me të vërtetë, kjo etimologji nuk arrin të spiegojë ndryshimet proteike të kësaj fjale. Nga këto, duke lënë mënjanë të tjerat burime, vetëm te, Kristoforidhi (f. 61, 200, 207) gjinden variantet *lëvezhë, lëvyshgë, lëvoçkë, lëvezhë, livoshgë, vëloçgë, luveshgë, gëlvoxa e arrës e vesë e qepës; vleshgë, gëlvojkë, gëvozhë, livoçgë, lëvozhgë*. Te Weigandi edhe *levoshk-a, vëljoçk, vlezhg*. Kjo e fundit edhe në Borsh të Bregut të Detit (M. Totoni). N. Frashëri (Dituritë 26) ka *lëvezhë*. Emëruesi i përbashkët i formave më *-o-* është *lëvozhgë*, i atyre më *-e-* *lëvezhë*. Këto janë një me *lëvoshkë* te Bashkimi e me *lëveshkë*, të Tase *lëvezhë*, vetëm se paraqiten me sonorizim të grupit *-shk-* në silabë fundore, ashtu p.sh. si te *plish: plizhë*. Morfologjikisht *lëvoshkë lëveshkë* shihet se janë zgjerime përkatësisht të fjalëve *lëvore lëvere* me sufiks *-shkë* (sh. për këtë Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 86 v.), duke rënë likuida në grupin e tri konsonanteve *rshk*, ashtu si te *bashkë* (leshi) nga *\*barshkë*. Format e tipit *oçkë, vlezhë* kanë dalë nga *lëvoçkë, lëvezhë* me anë metateze. Te *gëlvohtë gëlvozhgë gëvoshkë* etj. shihet dhe prania e prefiksit *gë-*; ky formant çfaqet që te Budi (SC 200 *gëvojë*), te Albania VIII 6 *gërvoja*, me varianten *gër-* të këtij prefiksi. Te *lëvoshkë lëvozhgë* nuk ka luajtur kuptimi i primitivit *lëvore*; për kuptimin e *lëvezhë-s* ndaj *lëvere-s* nga ka dalë, khs. *lvare fiku* te Gazulli.

**lifqër** m. ”ujvarë, katarakt”. Fjalë e dialektit të Bërzheshit. Pas Xhuvanit (Kopështi letrar I, Nr. 5, f. 9) nga lat. *liquor*.

Fjala latine nuk gjendet në gjuhët romane; përveç asaj në shqipen lat. *liquorem* do të kish dhënë *\*lëkuer \*lëkuar*. Është fjalë vendi, nga një bazë *\*livjër*, përngjijtje e *oçjerr* me *të- li-*. Kështu fjala del një variante fonetike e *lëvirë* ”rreckë mali, prroskë; grua e ligë”, *lavjerrë* ”ujvarë”, dhe e disa të tjerave që përmenden te *lavire, lavjerrës, lavare, kalivare, kalivaç*. Spiranti *j* ndrohet shpeshherë me okluzivin *q*; sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 1 (1958) 33 vv.; khs. dhe *kanosjar kanosqar kanusqar, shqer çjer, tamahqar tamahjar, zijosur zgjosur* (Mann), *syrgjyn: surjun*, sh. edhe *sjar*. Te prefiksi *lë- ë-ja* kaloi në *i* në pozicion përpara theksit, si shpeshherë, sidomos në gegërishten. Për kuptimin e fjalës khs. *ujvarë*, në Tepelenë e Përmet *ujvartë* f. ”katarakt” (Illyria I Nr. 4, 25. I. 1936, f. 8) (*ujë e var-*), dhe *Qafa e Ujit Verrë* (për *oçjerrë*) në Flet të Kabashit (Exeu rrens, Leka VI 199=Gj. Karma, Folklorë II 29, sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 3, 1958, f. 73); sh. dhe *Kalivaç, Ljarje*.

**lik** m. II. ”nivel, rrafsh”; *për lik të dheut, lik me dhenë* ”rrafsh me dhe”; ”tamam, drejt bash”: *lik për gjysëm*. Del në burimet pas G. Meyerit; te Gazulli *lik përmet balozit te i ka rá*. Si fjalë e geg. veriore rrjedh nga një serbokr. *lik në ná-lik* ”i përgjashëm”, *pri-lika* ”rast; tipar; gjë e gjashme”, *s-lik* ”rimë” *s-lika* ”pamje, figurë”, *lice* ”fytyrë, faqe, pamje; sipërfaqe e lëmuar, e rrafshët”, *licema* ”në të njëjtin rrafsh”. Primitivi *lik* në atë gjuhë do të thotë sot ”pamje, trajtë, fytyrë, dukë”. Po shqipja ruan disa llavizma që sllavishtja jugore ndërkaq i ka bjerrë; sh. për këtë Jokl në Sbornik Miletić 118 vv.

**lingë** f. "zile e vogël; zile e bagëtisë"; *lingëz* f. "lingë e vogël". Fjalë e geg. veriore, që s'e ka G. Meyeri, po e jep Bashkimi. Mbase një formim onomatopeik.

**lipë** f. "bliri, Tilia". Mungon te G. Meyeri. Në Osojë të Oparit e në Përmet; për Opar e ka dhe Mitruhi 219. Huazim krahinor nga sllav. *lipa* "bli", pas rrethanave dialektgjegrafike nga bullgarishtja.

**lisa** fql. "liqtë": *pëlhurë me dy palë lisa*". Fjalë e tosk. lindore të anës së Korçës. Si e kemi shënuar dhe te Bul. për Shk. Shoq.-2 (1954) 46 v. huazim krahinor prej bullgarishtes: *lesa* "trinë, gardh, thurimë". Sh. edhe *lesë* I. e *leste*.

**logori** f. "vaje"; *logoris* "vajtoj një të vdekur". Këtë fjalë, që e merr prej Mitkos, G. Meyeri 245 e bashkon me *ligje* "vargje që numëron një grua kur vajton një të vdekur në mort". Për Kristoforidhin f. 211 rrjedh prej gr. *λόγος, κλαίω μέ λόγους* "qaj me vome, me ligje". Pas Joklit (Wörter und Sachen XII 88) vjen nga gr. e re *μυρολογώ* "vajtoj, qaj një të vdekur", spjegim me të cilin bashkoheshim dhe ne në Bul. për Shk. Shoq.-2 (1954) 45.

Fjalë më fort të toskërishtes jugore. Për arsye formale nuk ka si bashkohet me *ligje*, as me gr. *λόγος*; gr. *μυρολογώ* ka dhënë në shqipëri *mirjollojis* (te G. Meyeri 279), te Grigori *mirollojisratë* fpl. Për të qarët me ligje përdoren shpesh verbet *numëroj, njeh*. Prandaj *logori* është një me *llogari*, e *logoris* me *llogaris*. Kjo dëshmohet edhe me anë të formave: te Boçari 8 gjejmë *llogori* për "aritmetikë", te Grigori (f. 504, Romakët 6, 11) *Të tillë lloi llogori të bëni edhe juvet*, edhe ky me kuptimin e *llogarisë*. Ndrimi i *l-s* velare me *l-në* palatale në pozicion nistor është i shpeshtë në gjuhën shqipe.

**loqe** f. "penis", *loqet* pl. "testiculi", në arbërishten e Italisë *loçkë*, pl. *loçka* "testiculi"; *loçka e zemrës*, fjalë përkëdhelëse e nënave për fëmijët e tyre. G. Meyeri 248 e afron me sllav. kishtare (serbokroate) *lokanja* "bark", te jevgjit e Bullgarisë *lokaçi* "membrum virile". Sh. edhe Berneker I 729. Këtë barazim Günterti (Wörter und Sachen XI 137) e zgjeron duke përfshirë dhe ags. *léow*, isl. e vj. *loer* "kofshë, shalë" e *leggr* "pulpë, kërcell".

Fjalë e mbarë gjuhës. Në tosk. jugore *dash monoloq* "dash me një bole", formuar me gr. *μόνο-* si te *μονοβίττα* "me një gji"; që trajton G. Meyeri (IF 6, 114). Plurali *lôqetë* "testiculi" (më rruan *loqet*) është i tosk. jugore dhe i shqipës së Greqisë. Reinholdi (Glosari 19) të më rruaish (rruanish) *lôqetë*, sh. dhe Laographia I 92 (për Atikë). Në arbërishten e Italisë (Kalabri, Sigeli) njihet vetëm *loçka* fql. "testiculi", sh. dhe Kamarda I 164; si toponim *Rahi L'ôçkavet* afër Sh. Mitrit në Kalabri (K. Kamsi Leka XV 59). Nuk ka dyshim se — sikundër e pa dhe G. Meyeri — *loçkë* shkon me *loqe*, si në kuptim konkret, si në abstraktin. Del sëpari te Bogdani (II 15, 11), *i vote ndë loçkë të zëmëresë* "andë su le viscere", te A. Sirdani (Leka IV 52) *loçka e zëmërs* "thalbi i zëmërs". Për kuptimin khs. sued. *kodd* "qese e boleve" e *kudd* "fëmijë e vogël". Për *loqe* "budallë, i marrë" sh. te *lole* — Në lidhje me etimologjinë e fjalës është për të vënë re se emri i testiculi-ve përdoret më të shumën në shumës, si te *bole, herdhe, koqe*. Duke u nisur së këtejmi, si e kemi shënuar edhe në Li. Posn. VII 184, te fem. *loqe* do kërkuar një plural me *-e* e me gutural të palatalizuar, i cili u singularizua. Kjo na çon te një \**lok* m. si singulari i vjetër i fjalës. Fjala kështu del e afër me lit. *liaukà*, pl. *liaukos* "gjëndër", let. *laukas* "një sëmundë, të anjturit e bajameve ndër derra". Në pikëpamje anatomike do shënuar se testiculi-të janë gjën dra; kështu edhe në gjerm. e lartë të vjetërën atyre u thoshnin *hegidros*, ku-*drosa* = gjerm. e sotme *Drüse* "gjëndër".

Në shqipen fjala në fillim, si të tjera emërtime të kësaj sfere, do të jetë përdorur si eufemizëm, me një zhvillim kuptimi nga "gjëndër" në "testiculi"; këto edhe sot quhen me eufemizëm, kështu në Elbasan pas Kristoforidhit *tamblat*. Në pikëpamje formale \**lok* paraqitet si refleksi i një baze \**l̥euk-*. Lit. *liaukà* Pederseni (St. baltici IV 151) e krahason me gr. *λεύκη* "një e dalë e bardhë, njollë e bardhë mbi lëkurë", duke pranuar një refleksin lituan të këtij diftongu indoeuropian pranojnë vetëm *au*; Sh. për këtë dhe Pisani, St. baltici V 99, po tani sëfundi edhe Fraenkel 362.

**luaj luej**, *loz*; *lodër* f. "lojë; daulle"; *lodërtār* m. "ai që i bie lodrës"; *lojë* f. G. Meyer (f. 248, Alb. Studien III 77, IV 93) mendon që *luaj* rrjedh prej lat. *ludere*, e që *loz lodër* me temën e tyre *lod-* afrohen me lit. *palode* "mujshi, madhëшти" *palodau* "rroj çthurur" *palodimas* "çthurje"; *loz* nga një bazë \**ladiō*. Etimologjia latine e *luaj* pranohet te Weigand 49. Pederseni përkundrazi (f. 152) vë re me të drejtë që *luaj* e *lodër loz* janë forma të një të vetme fjalë, e cila mbi dëshminë e *lodër-s* ka mbaruar me *-d*, dhe shton se gjasia me lat. *ludo* është një gjë e rastit. Mendimin që te verbet më *-uaj -uej* shihet prania e vokalit të gjatë të temës dhe zhdukja e një konsonanti ndërvokalik të zëshëm, e zhvillon Jokli (Studien 75. LKU 224, Archivum Romanicum XXIV 20v.). Khs. dhe Tagliavini 177.

Nga dy format e fjalës, *loz* është primarja, *luaj* analogjike, Pedersen 12. Kuptimet janë: për transitivin "e lëviz nga vendi; loz një lodër", për intransitivin "lëviz nga vendi ku isha; shkalloj, dal menj". Prej kuptimit të lodrës ka dalë edhe *luaj* "tallem, bëj shaka". Edhe i të tjerave gjuhë ballkanike është "heq valle, vallëzoj", sh. Sandfeld 88. — Del që te Buzuku (LXXV/2=LXXXXV/2, Korintasit I 10,7; XLII, Isaia 58,6; L, Luka 15,25): *Ndenj populli me ngranë e me pīm, e mbasandaj u ngri-tinë me luojtunë* "Sedit populus manducare et bibere, et surrexerunt ludere"; *zgidh të nlidhunitë e lodrësë* "solve fasciculos deprimentes" (*lodrësë* gabimisht për lat. *iugum* it. *giogo*, duke ngatërruar ky autor it. *giogo* me ven. *zogo* it. *gioco* "lodër"); *e tue ardhunë u afëruo shtëpisë, gjegj lodër-titë e valletë* "et cum veniret, et appropinquaret domui, audivit symphoniam, et chorum". Budi (SC 48) *A mos kishnje ndr ato dit shinte luojtunë nvalle... e qishdo ashtu tjetër lodërtie*; Bardhi *Ludere Me luetunë*, Lusor *Lodërtār*, Ludus *Lodër*; Bogdani (I 26, 34; II 110,10) *i pari qi luen, e silletë* "il primo tra tutti li Cieli, che si muovono"; *të padashunit'e fortë t'at'i Polemi, e të luejtunit'e tyne të pamasëtë* "l'ingratitude grande del Popolo, e sua mobiltà indicibile", emrat (I 30, 50; II 56, 21) *Andaj bijenë lodërti-vet* "per il che sonano gl'instrumenti"; *rij tue pritunë lodërrë e Ujit* "stava aspettando il moto d'acque". Grigori (Apostujt 21, 30) *E luajti gjithë qutei* "ἐκινήθη ἡ πόλις ὅλη". Pederseni 38 *edhe e loi kälënë mbërnda në avlli*. Në Hydra (Reinhold Tekste 20) *Andrioti më luan sinë*. Nga këto të dhëna del se kuptimi bazë i fjalës është "lëviz". Për *luaj* "shkalloj, dal menj" khs. gjerm. *verrückt* "i marrë", që ka dalë nga kuptimi konkret që ka *verrücken* "me e luejtë vendit, me shpërngulë (khs. Kieckers IF 23, 364). Në këto rrethana *luaj luej* nga një bazë shqiptare \**lod-nj*, *parashq. \*Ted-niō*, mund të jetë e afër me irl. e vj. *luaid* "lëviz, përmend, shpreh", *imluadi* "exagitat, vë në lëvizje", *imluad* "agitatio", *forluadi* "valvit". Fjalën kelte Pederseni (Kelt. Gram. II 572) e krahason me gjerm. e lartë të vj. *fliozzan*, nord. e vj. *fliota* "me rrjedhë", po khs. Walde-Pokorny II 95, 417, Pokorny I 837.

**luân luâ** m. Spiegimin e G. Meyerit (f. 249) nga lat. *leonem* e ndjek dhe Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1047. Jokli (LKU 89; IF 50, 49 vv.)

shënon formën me metatezë *ulā ulani*, dhe vë re me të drejtë që lat. *leonem* do të kish dhënë geg. \**lue* \**loi* \**loni*, tosk. \**lua* \**loi*. Mbi dëshminë e formës pl. *luanjezt* të Bogdanit (II 130,2) ky dijetar është kundër etimologjisë latine dhe sheh te kjo fjalë refleksin e sllav. *lvœ* (fonetikisht *lue*) "këlysh luani" (sh. dhe *lefa*). Pranuar te Walde-Hofmann I 785.

Tosk. *luân*, toskizimi i geg. *luâ*, është sot trajta e gjuhës së shkrimit. Në toskërishten fjala nuk është popullore, sikundër shihet nga mungesa e saj në të folët e Arbëreshëve t'Italisë e të Greqisë. Trajta popullore e gegërishtes është *luâ luani*, pl. *luânj*. Kështu te Buzuku (LXXXII/2=CII/2, Ezekiel 1, 10; LX 2, Danieli 14, 30) *fagenë n nieriut, e n luani mb anë të djathë t'atyne katërave* "facies hominis, et facies leonis a dextris ipsorum quattuor"; *E ata e qitnë ndë liqë të luanjet* "Qui miserunt eum in lacum leonum". Edhe Bardhi *Leo Luâ*, Bogdani (II 26 12) *luâ luani*, pl. *luanjet*. — Spiegimi nga sllav. *lvœ* është i vështirë, se nga kjo bazë do të pritej \**lué*; *gjáj* për *gjéj* është një mbështetëse fort e pakë në këtë vështrim. Mund të mendohet që lat. *leonem* dha rregullisht \**luo* \**loni* dhe që në fazën paraletrare të gjuhës iu ngjiti emrit sufiksi augmentativ -*ani* që në geg. veriore shënon mashkullin sidomos ndër shpes. si *patá, oidá*. Kështu \**luo* u bë *luâ luani*. Ky spjegim është më afër menç edhe nga ana kulturhistorike, sepse është vështirë të mendohet që shqipja emrin e kësaj shtaze të mos e ketë pasur në kohën parasllave. Në toskërishten fjala nuk është e gurrës popullore; atje ka hyrë vonë, e me anë shkrimesh, nga gegërishtja.

**lukër** f. "dele; tufë dhensh". Fjalë që s'e ka G. Meyeri; me kuptimin e parë në Veri, me të dytin në anët e Labërisë. Si e ka shtjelluar Jokli LKU 257vv., bashkë me rum. *lucru* "gjë, send, punë" më fort nga lat. ballkanike *lucrum* "fitim, dobi, pasuri" sesa një huazim nga rumanishtja. Ky mendim përforcohet me faktin që likuida nistore e fjalës së shqipes është palatale, ashtu si zakonisht në huazimet latine të shqipes, sh. *Revue de Linguistique* VII 1 179.

**lukuní, lukunjé** f. "llavë ujqsh. zogori". Fjalë e toskërishtes, në formën e parë të Fjal. i gju. shqipe, në të dytën në të folët e Gjirokastrës. Prej gr. së re **λακυνιά** "turmë mushkash e kuajsh" nga lat. *lacinia*, po prej një forme **λακυνιά** ose **λακυνιά** lidhur me **λύκος** "ujk", të cilën G. Meyeri (Ngri. Studien III 37) e quan grafi të gabuar. Nga dy format e shqipes, *lukunjé* me -*é*-në e saj i afrohet më fort fjalës greke. Përkundrazi *lukuní* ka shkuar pas femërove me -*i*. Fjala greke ka hyrë dhe në aromunishte, si *licnie*, sh. Papahagi 626.

